

85H-32

22

MOISI ZALOSHNA

ZERA
TE
FUQISHEM

TREGIME

891.983-32

Z 22

MOISI ZALOSHNAJA

S

ZERA TË FUQISHËM

(TREGIME)

48609

3456

SHËPTEJA E SHTRYERIT
NODURNI

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PAS MBLEDHJES

Kur u kthye Fatmira nga mbledhja, e vjehrра po tundte kosin nё tundës dhe nuk e ndjeu. Nё konakun tjetër, djali, lidhur nё djepe, ishte zgjuar e po qante. I kishte ardhur koha pёr tё pirё. Ajo ngjiti shkallët shpejt e shpejt, kaloi nё-pёr çardhak dhe shkoi u ul pranë djalit, e dёrsitur. I zbuloi fytyrёn foshnjës, dhe ai, me tё parë tё ёmёn, pushoi. Dukej qё e kishte marrë shumë uria. Fatmira fshiu djersët e priti sa u ftoh, sepse mamia e kishte kёshilluar qё kurrë tё mos i jepte gji fёmijës kur ishte e nxehтё, pastaj ktheu djeppen mёnjanë, mbёshteti si e lodhur, krahun e djathhtё mbi rrethin e saj tё kreut dhe foshnja filloi tё ndillte qumёshtin, e uritur. Nё kёtё çast asaj i shpёtuан lotët dhe filloi tё qante nё hesh-tje. Fytyra e rrahur nga dielli e nga era i qe bёrё si ai bakri i kuq, dhe pёrbrenda ndjente njё tronditje tё thellё qё i pasqyrohej nё sytё e saj tё bukur, por tё trishtuar, e qё dukej sikur pyesnin: «A mund ta kaloj jetёn kёshtu?»

Kur pas martese njeriu, burri ose gruaja, humbet vrullin rinor, gёzimet, ёndёrrimet, shpresat rimore, ajo martesë nuk ёshtё kurrë e lumtur. Atё kohё Fatmira ishte kthyer nga mbledhja

e fshatit. Atje kishte ndodhur diçka e papëlqyer, e turpshme. Rizai, kryetari i këshillit të Frontit Demokratik të katundit Bletëz, ishte ngritur nga presidiumi i mbledhjes dhe kishte thënë: «Unë propozoj për në listën e kandidatëve që do të zgjidhen anëtarë të këshillit popullor të lokalitetit tonë, shoqen Fatmira Serani. I gjithë fshati, të gjithë kooperativistët, e njohin atë...» Rizai kishte numëruar vetitë e mira të saj. «Sa për të meta, ajo mund të ketë», kishte thënë ai, «Por unë nuk i njoh ndonjë të metë që ta pengojë për të mos u vënë në listë. Vetëm i them nga ana ime, se, që kur u martua, sikur nuk është më ajo e para; jo në punë, por në këto aktivitetet... Por ajo e di vetë... Shkurt,» e kishte mbyllur fjalën e vet Rizai, «unë mendoj se shoqja Fatmira e meriton plotësisht të na përfaqësojë ne në këshilllin popullor të lokalitetit». Fatmira i kishte dëgjuar fjalët e Rizait me sytë përdhe, sepse ai e kishte mburrur shumë. Kishte thënë për të fjalë aq të mira, që ajo kurrë nuk i kishte dëgjuar ndonjëherë tjetër. Por edhe kritikat që i kishte bërë ishin plotësisht me vend. Duke e dëgjuar ndjeu një kënaqësi të thellë që ja çmonin punën e përpjekjet. Ajo nuk kishte punuar kurrë për t'u dukur e për t'u mburrur, por sepse te puna përfshatin gjente burimin e tërë kënaqësive dhe gjëzimeve të veta. Dëshirat e Fatmirës ishin që kooperativa të ecte mbarë, këshilli i fshatit të punonte mirë, organizata e gruas të ndihmonte sa të ishte e mundur më shumë, në punët e kooperativës... Dhe kooperativa e tyre të ishte në ballë të të gjithave, të përmendej kudo veç për mirë, fshati

të jetonte në kamje e të ecte gjithmonë sa më përparrë drejt begatissë e mirëqenjës më të madhe.

Duke dëgjuar fjalët e mira dhe kritikat që ishin thënë për të, ajo kishte psherëtitur e kishte thënë me vete, si t'i drejtohej propozonjësit: «Ah, sikur ta dije ti shoku Riza, se ç'luftë e sherr ngrihet në shtëpinë time nga burri, pse unë dal, pse unë punoj, pse unë aktivizohem?...» Dhe në këtë çast i qe dredhur trupi nga frika se mos Qemali, i shoqi, ngrihej edhe aty në mbledhje dhe bënte ndonjë marrëzi. Prandaj, coi pak kryet dhe vështroi më bishtin e syrit andej nga qe ulur i shoqi. Qemali qe bërë flakë i kuq dhe nuk e mbante vendi. Sa mezi priste që të mbaron-te fjalën propozonjësi e të çohet. Ajo e dinte mirë ç'mund të nxirritë nga goja ai njeri kur i shkonte buza vesh më vesh si tani. Vetëvetiu emri i saj qe vënë në listë, sepse ndërkohë që Rizai fliste, e gjithë salsa ngrinte duart e gëzuar dhe thërriste si rië kor: «Të vihet në listë Fatmira. Jemi plotësisht në një mendje me shokun Riza. Fatmira e meriton.»

Kur pa Qemalin, tërë gëzimi që kishte ndjerë iu shua në çast dhe iu këputën krahët.

Sapo mbaroi fjalën Rizai, Qemali u ngrit, dhe duke iu akërruar gjithë sallës, thirri si i çmendur: «Të hiqet gruaja ime nga lista! Të hiqet gruaja ime! Ajo ka fëmijë! Nuk dua unë!» «Jam e zonja që edhe fëmijët t'i rrit edhe të gjitha punët t'i bëj!» deshi t'ja priste Fatmira mu në mes të mbledhjes, për ta bërë që ta mblidhët bishtin njëherë e mirë, të pushonte e ta kuptonte ç'grua kishte. Por e përbajti veten me shumë zor, sepse

mendoi mos kushedi, njerëzit, që nuk e dinin si shkonte me burrin, do të kujtonin se ishte e djegur për të marrë përgjegjësira e për t'u dukur ndër të tjerët.

Të gjithë sa ishin në sallë e vështruan të çuditur Qemalin, të cilit i kishin dalë sytë përjashta duke shikuar me egërsi sa në një cep, në tjetrin dhe rrinte me gojën hapur sikur donte të ulërinte: «Ma lini gruan time rehat!» Pastaj zunë e po vështronin njëri-tjetrin me një shprehje hobia në fytyrë, si t'i thoshin shoshoqit: «Ç'qenka ky i krisur kështu?!»

Fatmirës i erdhi kaq turp e kaq rëndë, saqë iu errën sytë. Për një çast nuk po dollonte dot veçse koka njerëzish e fytyra të panjohura. Trupi i dridhej dhe iu duk sikur ra ajo Vatra e Kulturës dhe e zuri nën vete.

— Epo mirë, — u dëgjua në fund një zë, të cilin Fatmira nuk e njohu i kujt qe, — e heqim nga lista.

Në tonin e atij që foli ndihej qartë shprehja popullore: «Ikë o qar, se na bie zarar». Të tjerët, me heshtjen e thellë që u bë për një sekondë, u duk sikur e aprovuan këtë propozim të dytë. Ajo heshtje u duk sikur tha: «Ta heqim që t'i myllitet goja këtij të lojturi! E kush nis tanë me të?!» Por pastaj filluan diskutimet dhe të gjithë ata që folën e bënë Qemalin për pesë para.

Këto po mendonte Fatmira duke i dhënë gjithë fëmijës. Përmes lotëve shihte ende fytyrën e egërsuar të të shoqit tek thërriste: «Të hiqet gruaja ime nga lista! Të hiqet!..» — «Gruaja ime,» — përsëriti me vete fjalët e Qemalit, njëloj sikur

të thotë: «Dhia ime. Lopa ime». E ç'jam unë?! Ç'më ka mua?! Skllave?! Kafshë për punë?! I ka mend-të në kokë ai njeri apo jo! Pse nuk u ngrita t'i tregoja vendin? Pa le të bënte ç'të donte. Le ta merrnin vesh të gjithë. Se edhe kështu nuk rrohet. Një ditë të gjitha do të dalin në shesh, po më mirë më shpejt se më vonë. Ose të mbledhë mendjen, ose ai të shikojë punën e vet dhe unë timen. «Turp», — përsëriti ajo me vete mendimet e saj, — e ç'turp! Kjo që bëri ai sot është turp më i madh. Unë duhej ta kisha parashikuar me kohë, se ai një ditë do ta bënte edhe këtë që bëri. Sikur ta kishin kundërshtuar sot me fjalë të ashpra atje në mbledhje, ai medoemos do të kishte bërë sherr. Pupu!.. — trupi iu rrënqeth i téri duke marrë me mend se ç'do të kishte ngjarë po të ishte ngritur vetëm një nga shokët e t'i thoshte Qemalit: «Ti rri shok. Ne nuk po të propozojmë ty...» Por ai nuk pat ç'të bënte, se shpërtheu e gjithë salla kundër tij; me kë të përfytej më parë?! «Ku derdhin të gjithë nga një pikë, bëhet një lumë i tërë,» thotë një fjalë e urtë, «dhe të rrëmben e, ose të fut në rrugë të drejtë, ose të çon në det e të mbyt.»

Si u vu qetësia, sekretari i organizatës bazë të partisë, shokë të tjerë anëtarë partie, kryetari i këshillit popullor të lokalitetit, të deleguar të kryesisë së Këshillit të Frontit Demokratik të rrethit, i folën të gjithë me radhë. Fatmira sillte ndër mend fjalët e tyre: »Shoku Qemal, nuk e kuqtojmë përsë kundërshton me kaq gjaknxehtësi. . . Gruaja jote është. . . Populli atë e çmon, e do, e nderon. . . Te ajo populli sheh. . . Ti, për-

kundrazi, ta kesh pér nder, sikundér e ka pér nder i térë fshati. . . Pastaj, mos harro se çdo njeri nga ne i pérket yetes, familjes, por i pérket edhe térë fshatit, térë shoqërisë. Dhe kur fshati, shoqëria, na e kanë nevojën, ne. . . Ja, tē shohim ç'do tē na thotë edhe vetë, shoqja Fatmira. . . »

Mirëpo Fatmira qe turbulluar aq shumë nga ai qëndrim i pahijshëm i tē shoqit, saqë kur ungrit e foli, nuk mundi tē shprehte ato që ndjente. Dhe tani qërtonte veten: «Përse nuk thashë unë: — «Shokë! unë jam e térë fshatit. Do tē bëj ashtu si doni ju. Burrin e kam burrë, fëmijët fëmijë, nënët nënë... por edhe fshati edhe shoqëria pér mua janë si shtëpia. Se pa shoqerinë asnjë nuk rron dot. Unë...» — Ah, sa shumë kishte pér tē thënë! Po mendimet e saj ja kishte mbetur nga shërimi i përbajtur me vështirësi. Megjithatë ajo u tha: — Unë, shokë, as jam kursyer as do tē kursehem. . . Mos më pyesni mua. . . Vendosni si ta dojë e mira e shoqërisë. . . »

Në këtë kohë u hap dera dhe hyri Qemali. Dukej që ishte ende i zëmëruar e kërkonte të shfrente.

Qe pranverë. Shtresat e konakut ishin ngritur tē gjitha dhe qenë palosur mbi dy sëndukë tē vendosur në fund, mbuluar me një mushama.

Ai u ul kundruall së shoqes në dysheme, i vuri shpatullat murit, shtriu këmbët dhe u gjirr sa u duk sikur u tund konaku:

— Po ti, ç'ke që qan?! Apo nga gjëzimi që do tē zgjidhesh tani edhe këshilltare?! Nuk i kishe mjaft zotria jote: kryetare e grave, në këshillin e fshatit, në kor (se ka shumë hixe: grua e martuar,

me dy fëmijë në prehër...). Ke vendosur të vazhdosh edhe shkollën e natës në shtator. Se pak punë kishe pér të harbuar ti, po do akoma!

Fatmira fshiu lotët. Zemërimi i saj u fashit menjëherë si të mos kishte ndodhur asgjë. E latë shoqin sa shfreu gjer në fund, duke e vështruar e qetë e me sy pyetës, si t'i thoshte: «Me gjithë mend i ke këto që thua, apo bën shaka?»

Në kujtesën e saj i erdhën ato ditë të rinisë kur Qemali i vinte rrëth, i cfaqte dashurinë, tre gohej i hedhur në jetë e si njeri i kohës, sikur ishin bërë mishi e gjaku i tij ato që thuheshin në mbledhjet e rinisë e që shkruheshin në gazeta, pér marrëdhënjet në familje, pér lumtërinë bashkëshortore. I kaluan pastaj si në një ekran filmi ditët e mëvonshme pas martese: si varte buzët Qemali kur ajo shkonte në mbledhje, si zemërohej kur vonohej, si i mbante mëri, si pati shpërthyer në grindë më vonë.

Dhe kur ai pati mbaruar, ajo iu drejtua:

— Si thua ti Qemal, unë kam dëshirë të punoj, të ndihmoj, të jem njeri i vlefshëm pér shoqerinë, apo kam dëshirë të harboj?

— Të harbosh! — përsëriti ai me një egërsi të papërbajtur. — Të harbosh! Të harbosh! Të kam thënë njëmijë herë: «Ç'të duhet ty në venë gratë te mamia apo jo? Ç'të duhet ty higjena në shtëpitë e tjera? Shiko tënden. Tymi yt të shkojë drejt. Pastaj, ku është puna më e vështirë, ti me skuadrën je në ballë. A e pe?! a e pe?! Mezi e realizove normën në korrjet këtë javë, se vajte more përsipër ku ishte gruri më i shkurtër, tërë gjëmba! Të gënjejnë ty: «si Fatmira s'ka» dhe ti

me ato bija mëntë, edhe në zjarr të të thonë «hidhu», je gati të hidhesh.

— Kush ka thënë: «si Fatmira s'ka»?

— Ja, sot atje në mbledhje, ç'thanë? Apo nuk i dëgjove zotrote?

— Sot?

— Po, sot, po kur?

— Sot ishte rasti. Po unë gjer sot nuk kam punuar pse kanë thënë: «si Fatmira s'ka». Pastaj përse nuk thanë për ty?

— Unë nuk jam llaçkë si ti.

— Jo, ti nuk je budalla. Por harron se, kush mendon të jetojë vetëm, vdes më parë nga të gjithë.

— Kam krahët unë, nuk vdes.

— Jo, për bukë nuk vdes njeri sot. Nuk ta kam atje. Por ç'e do jetën kur... Pastaj, a nuk e di ti se ata krahë, veç shokëve, nuk janë tjetër veçse dy shkarpa të thata??!

Si mbaroi mbledhja Qemali kishte qëndruar në Vatrën e Kulturës si shumë të tjerë dhe kishët dashur të loste një domino a diçka tjetër, por të gjithë e kishin shikuar vëngër, me të ftohtë e padëshirë të uleshin në një trapezë me të. Ishte ngritur që andej me ndërgjegje të vrarë e me mëri sa ndaj gjithë fshatit edhe ndaj së shoqes dhe donte tanë të shfrente dufin e të përbuzurit.

— Por le t'i lemë këto, — vazhdoi Fatmira. — Ti, në qoftë se më merr si njeri që dua të harboj, unë ja ku po ta them një herë e mirë se nuk jam e atillë, prandaj edhe nuk dua ta dëgjoj dy herë nga goja jote këtë fjälë. Po më more për të atillë, atëhere është më mirë të ndahemi. Ndarja është

kapak floriri, në këto raste, — tha ajo me një ton të qetë, sikur t'i thosh për një gjë fare të thjeshtë e të parëndësishme: — Por dije se unë, në e kam rojtur e në do ta ruaj nderin tim, këtë nuk e bëj pér ty, jo, por pér vete. Nderi im është imi, jo yti. Në qofsha e pandershme, ti ndahesh nga unë e merr një tjetër. Një gjë të tillë do të bëja edhe unë. Prandaj, pér atë që mendon ti, as ty nuk të zë turpi im, as mua nuk më zë yti. Por unë dua të jem ballëlarë përrpara njerëzisë pér veten time.

Qetësia me të cilën po i fliste, e trëmbi Qemalini njëmijë herë më shumë se t'i ishte çirrur e t'i kishte ulëritur. Edhe sot ai, si në çdo grindje tjetër, kuptoi sa më e gjykueshme ishte e shoqja ndaj tij, e megjithëse bënte përpjekje të mos e aprovonte këtë e të mos e ndjente veten të përulur ndaj saj, e vërteta ishte e vërtetë e nuk mund të fshihej.

— Po, — vazhdoi Fatmira me zë të lartë e me një ton sigurie pér atë që shprehte, — mua më zë turpi pér marrëzitë që bën ti, si ajo që bëre sot. E ç'pate që u bëre ashtu si i lojtur? Bën ç'bën në shtëpi, nuk të sheh njeri, nuk të di njeri; po në mes të mbledhjes? Po në mes të fshatit? Po në sy të të deleguarve të rrethit, të shokëve të lokalitetit? — ajo çori faqet me duar. — Turp! Turp! — përsëriti disa herë. — Ja këto turpe më zënë mua. Se kushedi ç'kujtojnë bota! Kushedi ç'mendojnë! «Ky që e ka në rrobat e di ç'grua ka», mund të mendojnë zemërliqjtë, megjithëse mua aq më bën. Ti vetes i ke bërë keq, or burrë, vetes! — thirri Fatmira këtë radhë pa u përbajtur.

Qemali shkrofëtiu dhe ndezi prapë një ciga-

re tjetër me bishtin e asaj që kishte në gojë.

Kryetari e sekretari i këshillit popullor të lokalitetit si edhe të deleguarit e rrëthit, kur kishin ikur, pas mbledhjes, ishin përcjellë me të dhe i kishin dhënë dorën ftohtë duke i thënë: «Mblidh mendjen, shoku Qemal, se nuk e këmirë!» Tërë shokët në Vatrën e Kulturës e kishin parë si një njeri që e ha bukën kot e sikur e ushqenin ata me qesen e tyre. Ja edhe gruaja në shtëpi i foli për ndarjen aq e qetë, sikur t'i thosh të ngriheshin të hanin drekën. Të gjitha këto e bënë Qemalin të ndjente një zbrazëtirë e një ankth të tmershëm në shpirt e një humnerë të llahtarshme përpara. Një zë, si i shurdhër në fllim, zu t'i thërriste që brenda vetes: Ej, njeriu rron me njerëz!»

— Ti mos kujto se kreve ndojnë heroizëm me atë që bëre sot, — vazhdoi Fatmira pa i hedhur sytë ta shikonte, dhe i hoqi gjinë fëmijës, i mbuloi fytyrën e po e tundte lehtë. — Kurrë s'ke nder me këto që bën e kështu si mendon ti, — tha ajo. — Njeriu nuk rron vetëm për një kafshatë bukë. Sot: një për të gjithë e të gjithë për një.

Qemali e dinte sa e zonja e gojës ishte Fatmira dhe drejtësisë së fjalëve të saj nuk mund t'u bënte ballë. Katër - pesë vjet më parë edhe ai kishte tjetër nder në fshat. Nuk kishte mbledhje të mos diskutonte. Fliste kurdoherë me ballëhapët. Të gjithë e dëgjonin me vëmendje. Kurse tani, edhe atë çikë nder që gëzonte, i dukej sikur e kish nga e shoqja, sepse ajo, edhe vajzë edhe nuse, nuk u shkëput nga aktivitetet shoqërore. Ajo kishte një dëshirë të tillë që, për të mirën e fshatit, të

mos thoshte kurrë «jo». Nga dashuria e singertë e nderimi që shfaqnin të tjerët për të, Qemalit i dukej sikur ajo nuk i përkiste atij. Ata që e nderonin më shumë, heshturazi i urrente më shumë. Kështu, ca nga ca, i lindi një mendim i ulët, si për inat të së shoqes, që ishte aq e papërtuar për të nderuar fshatin, të mos shkonte vetë atje ku e kërkonte shoqëria dhe të ndalonte edhe të shoqen. «Ç'të duhet ty tani të vesh në festival!...» «Pse të mos vemi?» «Ne kemi të tjera halle tani. Pastaj edhe nëna, edhe babai...» «Nëna dhe babai e dinë...» «E dinë e dinë, po...» — «Ç'të duhet ty përgjegjësia e skuadrës. Pse të vesh në mbledhje? Puno, bëj normën tënde; ç'të duhen ty ato punë, se pastaj të bëjnë edhe brigadiere». — Ose: «Ehu, sa punë ka fshati, këshilli popullor, t'i bësh të téra, veç të heqësh dorë nga shtëpia». Mirëpo Fatmira nuk tërhiqeja prej mendimeve të tij. Atëhere, dëshira e saj për t'iu gjendur të gjithëve, për t'u bërë mirë të gjithëve, natyra e saj me të gjithë e qeshur, me të gjithë e ciltër, e gëzuar, e tërbonin më keq Qemalin, dhe, sa më shumë punonte ajo, aq më shumë tërhiqeja ai nga punët shoqërore për inat të saj. Gjersa më në fund, si u bë edhe me fëmijë, filloj edhe grindën. Duke u shkëputur nga interesat e shoqërisë, ai tërhiqte me vete edhe mospërfilljen e saj. Kjo gjë, në vend që ta bënte t'i vinte gishtin kokës, e shtynte edhe më tepër drejt mërisë ndaj së shoqes e tërë fshatit. Mirëpo, kur pas mbledhjes, Fatmira iku e para nga turpi për të e ai mbeti, e kur i dhanë dorën aq me të ftohtë të përcilleshin kryetari i lokalitetit, të dele-guarit, ai u trondit shumë. Në këtë rast e ndjeu

më gjallë se kurrë ndonjë herë tjetër se mëria që kishte ndaj shoqërisë në shpirt, iu përplas ftyrës aq pa mëshirë, saqë i dukej sikur të gjithë i kishin hedhur nga një pllackë pështyme në ftyrë.

Që në sallën e Vatrës së Kulturës, edhe rru-gës duke u kthyer për në shtëpi, edhe aty në dhomë ku ishte, ai po mendonte: «Ose gruaja duhet të më bindet mua, ose unë t'i bindem asaj dhe të bëhem ai që kam qenë, ose të ndahem prej saj. «Por edhe që të ndahem», mendonte me vete, «gjë nuk do fitoj. Të gjithë do të më shajnë». Duke ardhur në shtëpi, plaka e Xhemalit, që ishte duke vaditur kopshtin, e kishte parë e i kishte thënë: «Lum ti për atë grua që ke, or Qemal! Ty të mban kërr, të larë e të ndërruar! Fëmijët i mban si drita! Shtëpinë si drita!.. Lum ti! Ja edhe në këshillin e lokalitetit, më tha djali, ta paskëshin zgjedhur. Po këndo, ore, këndo ditë e natë, për atë grua që ke, ç'më rri ashtu sikur të ka ngrënë gomari bukën! Me një sy të jesh e një grua të atillë të kesh në shtëpi».

Ngriti sytë dhe vështroi Fatmirën, që i kishte vënë edhe ajo shpatullat murit e po tundte djen pen lehtë me këmbë. Vështrimi i tij ishte i zymtë, e fliste shumë. Ajo rrinte e menduar. Në ftyrën e saj të bukur vuri re si gjithmonë një shprehje vendosmërie të patundur.

Që kur ishte e vogël, shtatë - tetë vjeçe, Fatmira kishte parë partizanët e partizanet me pushkë e automatikë në krahë. Njëra nga partizanet, me shpatulla të mbushura e kraharor të bëshëm, me trup të drejtë e të fuqishëm, e gjatë sa Fatmira sot, me një mitroloz të lehtë në krahë, i kishte

mbetur e gjallë ndër sy edhe sot e kësaj dite. Partizanja, pasi kishte ngrënë bukë në shtëpinë e tyre, e kishte marrë në prehier, e kishte përgëzuar e i kishte thënë:

— Ç'do të bëhesh ti kur të çlirohet Shqipëria e kur të rritesh?

Dhe Fatmira, duke lojtur me gërshetat e partizanes, i qe përgjigjur:

— Ja kështu si ti.

Partizanja e kishte puthur fort dhe e kishte shtrënguar në gjii.

— Ti do të vesh në shkollë, do të mësosh... E ëma e Fatmirës, që ishte duke fshirë thërrimet, qe hedhur:

— Uh, shkollë e zezë e asaj! Ajo është jetime. Kush do ta çojë në shkollë atë? Ne s'kemi as shkollë, as gjë këtu në fshat.

— Ka Partinë kjo... — kishte thënë partizanja, e cila më shumë i ngjante një djali të gjallë e të shkathët se një vajze, e që Fatmira, që atëhere e kishte zgjedhur si vajzën që donte t'i shembellente.

Pas lufte, si u hap shkolla fillore në Bletëz e si mësoi shkrim e këndim, sa herë që lexonte copat e këndimit ku flitej për Luftën nacional-çlirimtare e për partizanët, Fatmirës i delte përpëra syve partizanja me mitroloz të lehtë në krahi, së cilës nuk ja mësoi emrin, por që ajo i vinte të gjithë emrat: Zonja Çurre, Margarita Tutulani, Shenaze Juka...

Edhe sot, tek rrinte ashtu e menduar, sepse iu kujtua partizanja e vet. Pastaj i erdhë ndër mend fjalët e një shoqëje të deleguar nga rrathi...

Zéri i trashë e i egër i Qemalit e shkëputi nga këto mendime.

— Ti, në do të jesh gruaja ime, — i tha ai me vështrim të zemëruar, — duhet të heqësh dorë nga të gjitha. Pse, s'ka të tjera këtu?!..

Fatmira ngriti kokën si e trëmbur dhe i nguli sytë:

— Si the?

— Atë që thashë.

— Unë jam gruaja jote, shoqja jote, — iu përgjegj ajo, — po jo dhia jote. Po të mos doja të isha gruaja jote, kisha ikur me kohë dhe askush nuk më ndalonte. Por mblidhe mendjen, se nuk është ashtu si thua ti: «Burri është çadëre e gruas». Mua, nën një çadëre si ti, më është zënë e më zihet fryma. As ta kam duruar, as ta duroj hijen e asaj çadëreje. Ti thua: «Një ka që e vret lopa s'ke ç'e do». Këto janë mendimet e tua të mykura. Këtu nuk është fjala që unë të të shtyp ty ose ti mua, por ta kuuptojmë njëri - tjetrin si dy shokë jete. Ja ku po ta them edhe një herë: jam gruaja jote, nëna e fëmijëve, nusja e shtëpisë dhe e tërë fshatit dhe e kooperativës. Kjo më nderon mua. Jo ajo që thua ti. Prandaj hiqi bëzhdilat nga koka.

— Hajde hiqmi zotëria jote, — foli me ironi Qemali dhe bëri sikur i zgjati kryet duke shpupurisur flokët.

— Po t'i kishe përjashta, vija një gjym në zjarr e t'i laja, por ti i ke brenda, brënda në tru!

Qemali ngriti grushtin dhe goditi dyshemenë.

— Ti do që të dukesh. Do që të të mburrin, të thonë «**Fatmira kështu e Fatmira ashtu.**» Prandaj leri profkat, — buçiti zëri i trashë dhe i egër i tij.

— Dhe ja ku po ta përsëris: në do që të jesh gruaja ime. . .

— Edhe ti, në do të jesh burri im, duhet të bësh ashtu si thotë Partia, si thotë populli, shoqëria. Unë nuk mund të rroj dot pa shoqërinë dhe sa të kem shpirtin do të punoj.

— Kësaj nuk është e mundur t'i kthehet koka, — mendoi Qemali me vete i egërsuar, po krejt i pafuqishëm me tërë egërsinë e vet, dhe u ngrit iku duke përplasur derën pas.

Kanatat e dritareve u hapën nga forca me të cilën u përplas dera dhe që jashtë hyri në dhomë një erë e fortë dhe e mbushi atë me aromën e luleve, të gjethit të ri e të barit të njomë.

Fatmira ndjeu freskinë e shijën e kësaj ere maji, i vloj gjaku në zemër, fshiu fytyrën në ngjyrë bro-nxi të kuq të shndritshëm, dhe një gëzim i papritur i përshkroi tërë trupin, si të kishte bërë një bisedë dashurie të ëmbël me të shoqin dhe jo një bisedë sherri e shamate. «Erë maji», tha me vete dhe vazhdoi me shpresë të ngazëllyer duke shikuar nga dera ku kaloi i shoqi dhe si të fliste me të: «Në shpirtin tënd ka ngritur krye të rëndët e prangave të së kaluarës. Mundohu, shkunde atë të rëndë, se për ndryshe as tunjatjeta nuk do të dëshirojë të të thotë njeri, or burrë». Pastaj si u mendua një sekondë prapë vazhdoi: «Do të të vinë mendtë edhe ty, do të të vinë».

Qemali, në dhomën tjetër, ku vajti të bënte gjumin e vapës, kuptoi se nuk do ta zinte gjumi, sepse nuk i hiqeshin nga mendja diskutimet e shoqueve dhe të shokëve, ftohtësia e tyre kur ishin

ndarë me të, dhe në veshë i bëhej sikur ndjente buçitjen e sallës:

— Fatmira e meriton!... Qemali nuk ka të drejtë! . . .

Kurse ai zëri i brëndshëm, i shurdhër në filim, sa vinte po bëhej më i fuqishëm dhe i thërriste së thelli:

— Ej, njeriu rron me njerëz! Nuk të ka faj gruaja! . . . Ti ke mbeturina . . .

— Mirë, — filloi të thoshte me vete, duke u kthyer sa në një krah në tjetrit, — mirë se Fatmira e meriton nderin, dashurinë, besimin e të gjithëve . . . po unë ç'meritoj?! po unë ç'duhet të bëj?!

FLETË NGA DITARI I NJË AGRONOMI

Beqir Sokolin, ish — shefin e seksionit të bujqësisë në rrëth, kisha gati një vit pa e parë. E takova pardje, kur kishte zbritur nga kooperativa malore «Partizani» për një mbledhje. Në mbrëmje e gjeta duke shkruar diçka në një fletore të trashë.

— S'paske hequr dorë nga burokracia? — e ngacmova.

Ai qeshi.

— S'merrem me burokraci, — m'u përgjegj; po përpinqem të bëhem shkrimitar. Që ditën që u ktheva në fshat nisa të mbaj ditar dhe, kohë më kohë, sa herë që jam i lirë, përpinqem t'i zgjeroj shënimet e shkurtëra. Ndoshta, ndonjë ditë, mund edhe t'i botoj.

Me lejen e tij shfletova ditarin. Ai nuk pati ndonjë kundërshtim që unë të kopjoj dy data.

5 mars 1966

Kur arrita te Kroj i Buzit, kufi me fshatin tim, i zbrita mushkës, iu hodha një dy herë ujë syve, e, meqë ishte herët, u ula mbi një gur dhe ndeza një cigare. Duke vështruar fshatin tim të ndarë në tri lagje, por shumë afër njëra - tjetrës, si të zëna

dorë për dore, sepse m'u duk për një çast sikur e shikoja për herë të parë.

Nga fshati kam më se njëzet e katër vjet që kam ikur. Dy vjet është ca kam qenë partizan. Pas çlirimit — përgjegjës i bujqësisë, pastaj në shkollën e partisë dhe prapë përgjegjës i bujqësisë në rrëth. Shkollën e mesme e kreva natën, bëra edhe dy vjet në Institutin e lartë bujqësor dhe pesë vjetët e fundit u caktova përsëri shef i seksionit të bujqësisë. Dje në mëngjez bëra dorëzimet e fundit. Kështu që e kam harruar jetën e fshtatit.

Te Kroj i Buzit kujtova edhe një herë shtëpi-në time në qytet, rehatinë... dhe ja tani sytë më vanë menjëherë nga shtëpia e babait në fshat e pastaj pushtova me një vështrim tërë sinorin e vendlindjes. «Po babai, mendova, si do të më presë?!» Për nënën e dija dhe isha i sigurtë që do të gëzohej. Kur dërgova, verën që kaloi, fëmijët këtu në fshat, nëna nuk donte të m'i linte dhe, kur u kthyen, ajo më tregonte: «Si më iku nusja me fëmijët, më duke sheshin këto shtëpi akull! Nuk më rrihej brenda! Gjeja ndonjë shenjë të fëmijëve, e merrja, e shtrëngojë në gjii dhe të gjitha i kam ruajtur në arkëz...»

Si mbarova cigaren, ndeza një të dytë, i hipë mushkës dhe mora përsëri rrugën. Ngado që çoja vështrimin më përshëndetnin të njohurit e mi të vjetër: arrat e Zdrëmçës, ku viaj vjeshtëve i mbli-dhja, Bregu i Memës, ku i bija fyellit me barinjtë e tjerë, Gurët e Gjetë, Ujët e Zharrëzës, ku piqnim misra të njomë...»

Kur arrita në shtëpi, dielli ishte fshehur prapa

malit. Rrugës, në të afruar dhe brenda në fshat, takova plot njerëz që më uruan:

— Erdhe? Mirë se na erdhe. E tregove edhe një herë se je biri i këtij vendi. Hajde, me faqe të bardhë.

Te muri i oborrit i zbrita mushkës, hapa tri-nën dhe hyra brenda. Babai po gdhendte një govatë në fund të oborrit. Ai nuk luajti nga vendi fare. Nëna doli te shkallët dhe iu kanos tim eti:

— Ngreu, o i zi, se na erdhi djali! — Pastaj u derdh nga unë: — Të keqen! Të keqen nëna!

— Më vuri kokën në kraharor e s'më lëshonte.

E di që babait i pëlqen njëçikë të mbahet e të mburret, prandaj edhe më brente pak dyshimi si do të më priste, por që të ish kaq i ftohtë nuk e pandehja. Kur pata shkuar herët e tjera në fshat, më dilte më priste gjer në fund të rrugës dhe duke thirrur që ta dëgjonin:

— Epo mirë se na erdhe, or bir. Mezi t'u bë mbarë. Sikur i ke vetëm ti mbi shpatulla të gjitha punët e këtij pushteti!

Po ngroheshim pas zjarrit me nënën kur erdhi babai. Hoqi opingat te dera dhe më tha që atje:

— Erdhe?

— Erdha, — iu përgjegja dhe u ngrita e përqafova.

— E muarëm lajmin që dy javë të shkuara, — tha duke u ulur, — po... — dhe nuk e mbaroi fjälën. Ai deshi të thoshte: «po nuk e besoja». Kurse unë u shtira sikur nuk e kuptova dhe vazhdova:

— Po u vonova gjersa bëra dorëzimet.

Biseda jonë ishte e shkurtër dhe e ftohtë nga ana e babait.

— Ngreu, — e urdhëroi nënën, — bjerna nga një kupë raki e nga një meze.

Duke ngritur gotën, më vështroi me vetulla të mbledhura, midis të cilave u formuan dy rrudha të thella, dhe më tha:

— Domethënë e vendose, erdhe?! — dhe me dorë bëri një lëvizje që donte të plotësonte atë që nuk e shprehu: — domethënë se mori fund.

— Po, po, — iu përgjegja, duke cikur gotat.

Heshtja vazhdoi e rëndë. Nëna e vështronë babanë me inat gjersa shpërtheu:

— Mor, po ti ç'ke me djalin, që m'i rri kështu? Ai nuk është i yogël. Di se ç'bën! Dhe di më shumë se ti, në paç pér të pyetur!

Ato që babai vlonët nga dëshira të m'i zbraste mua, ja përplasi nënës; por, si i thonë fjalës, «foli plakës, të dëgjojë nusja»:

— Di, di, po nuk di! Se kur vija në pazar, më hidhnin duart në qafë njerëzia dhe më thoshin: «Si je, baba i përgjegjësit? Si të kemi?». Unë mora vesh ç'kishte bërë ky dhe sado që s'më mbante vendi, nuk dola në pazar.

— Ai shef ka qenë edhe shef është!

— Po, po, — u tall babai. — Gjer dje komandonte një rrëth të tërë: njëqind e njëzet e ca fshatra, kurse tanë do të të komandojë ty, do të komandojë Nasipen e Nuriut, Ryvedinë e Dikes...

Pastaj u kthyte nga unë, si pa gjë të keq e sikur të mos më kishte sharë pak më parë:

— Tjetër ç'kemi andej nga qyteti?

— S'ka gjë, baba. Letra e Hapur e Partisë na shkundi në shumë gjëra.

I tregova për zotimin, që kisha marrë në mbledhjen e aparatit të komitetit ekzekutiv për të lënë zyrën e për të shkuar në vijën e parë të frontit të punës.

Më dëgjoi gjer në fund pa ngritur kryet të vështronte dhe, kur unë ngrita gotën ta çik me të, më pyeti:

— Domethënë ti iu përgjegje Letrës? S'ka gjë tjetër? — Tundi kryet si të mos besonte me një heshtje enigmatike.

— Ç'të ketë tjetër?!

Në këtë kohë na erdhën pasdarke kryetari i kooperativës, sekretari i organizatës bazë të partisë, dhe dhjetë shokë të tjera të kryesisë së koooperativës e anëtarë të thjeshtë. Më vonë erdhën edhe fqinjët. U mbush dhoma plot. Midis tyre që edhe instruktori i komitetit të partisë për rrithin. Babai, tërë kohën që ndenjën ata, foli shumë pak. I vështronte gjithë të ardhurit me sy hetonjës e në mënyrë të veçantë më vështronte mua kur kuvendoja me ta. Menjëherë e kuptova se atë e brente diçka më e madhe se vendimi im përkthimin në fshat. Po çfarë? Nuk munda ta gjeja dot me mend në ato caste, veçse më vonë.

Duke biseduar, instruktori i partisë bëri shaka me babanë duke më treguar mua:

— Shqiponjë e ke këtë djalë, shqiponjë. Një bëre, po ke ditur ç'ke bërë, shoku Jonuz!

— Shqiponjë e bëri Partia, — iu përgjegj babai, — se shqiponjë është vetë ajo.

Për të parën herë, gjatë gjithë mbrëmjes,

mezi e pashë babanë që të buzëqeshte një herë.

Pastaj instruktori më pyeti mua:

— Sa fëmijë ke?

— Katër.

Ai iu kthyte përsëri babait:

— Shoku Jonuz, paske një skuadër me nipër e mbesa!

Babai prapë vuri buzën në gaz.

Ne vazhduam bisedën për tokat e reja që mund të hapim, për tarracat, për sektorët ku mund të mbjellim patate... për gjithë problemet e kooperativës. Dhe kur ishte rasti, shokët thoshin: «Ja, tani kemi edhe shokun Beqir që do të na ndihmojë». Në tonin e singertë të tyre ndihej gëzim, shpresë... dhe babai më dukej sikur pyeste me vete: «ja thonë me gjithë zemër djalit këta këto fjalë, apo?...»

Para se të ikte sot pasdite instruktori i komitetit të partisë, pata këtë bisedë me të:

— E di ç'më tha babai yt?! — më pyeti duke vënë buzën në gaz.

— Jo! — iu përgjegja kureshtar.

— Babai yt më hoqi mënjanë dhe më pyeti: «Të më thuash drejt: ka bërë gjë djali im apo jo?» Ka bërë, i thashë, ka bërë një gjë të madhe. U nxi në fytyrë dhe gati sa s'bërtiste: «Në ka bërrë gjë, në nuk i ka punët mirë me Partinë, mos ma sillni këtu, në fshat. Ta vuajë ku të dojë fajin që ka bërë. Se djalë e kam, të vetëm e kam, por...» Qesha me të madhe dhe e pushtova. Baba Jonuz, i thashë, djali yt ka bërë një gjë të madhe, por jo kundra Partisë, po ashtu siç do Partia. Iu kthjellua fytyra menjëherë dhe ashtu

siç e ka ai, më uroi prerë: «Udhë e mbarë».

Tani e kuptova që babai mbrëmë rrinte i vrërët se e mundonte sedra e tij. Atij i pëlqente të dukej. E ngiste edhe meraku se mos unë erdha si fajtor e jo si vullnetar, por nuk e kuptoj akoma se ç'e kishte shtyrë të mendonte në atë mënyrë. Po edhe këtë e mësova. Atij dikush i paskesh thënë:

— Nuk e luanin tët bir, jo, nga qyteti, po diku ka shkarë keq...

20 shkurt 1967

Dje kishim mbledhjen e asamblesë së kooperativës. Unë dhashë raportin në emër të kryesisë. Në jetën time rrallë kam provuar gjëzim e krenari të tillë. E kam provuar gjatë luftës, kur zbrisnim në fshatrat e qytetet që çlironim dhe kur populli na delte i téri, na puthte e na përqafonte me gjëzim të papërmabjatur. Ky gjëzim e kjo krenari m'u përtéri edhe dje. Ndoshta dje unë thashë me téré shpirtin: «Sa mirë bëra që iu përgjegja Thirrjes së Partis». Diku kam lexuar, nuk e mbaj mend, se «lumtëria më e madhe e njeriut është kur sheh se nxjerr një punë të mirë nga duart e tij». Por lumtérinë e punës së mirë dje nuk e provova vetëm unë, atë e ndjenë të gjithë kooperativistët. Ne dje bëmë llogaritë përfundimtare sa na takon dita e punës dhe pamë përparimin që ka bërë kooperativa jonë.

Ndoshta dje edhe babai do ta ketë shkulur fijen e fundit të mërisë ndaj meje që s'jam «kumandar i njëqind e njëzet fshatrave, por erdha të komandoj Nasiben, Hyrinë...» E them këtë sepse, ndërsa unë shkruaj për mbresat e ditës në dita-

rin tim, ai m'u lut me dhemshurinë dhe dashurinë e një babai krenar për djalin, që e nderon, që ja duan të gjithë:

—Po mjaft, or bir, se u lodhe, u këpüte! Lëri tani ato shkresa. Hajde të pimë nga një gotë, se kemi vit të ri!

U ula me të, ai në një kënd, unë në tjetrin përkundrejt dhe, duke cikur gotat e duke u parë sy më sy, më dukej sikur më kujtonte ditët e kaluara dhe më kërkonte ndjesë me heshtjen e tij, që fliste më shumë se fjalët: «Më fal, o bir, se ti lodheshe, këputeshë dhe unë të haja shpirtin duke të thënë: — Poo, le rahani dhe kërkove belanë! Ti do të bësh njerëz ca e ca që s'kanë bërë prokopi kurrë! Por jo, me shokët e mirë që të dhanë dorën e që u dhe dorën, u bë jotja, jo imja...»

Si piu tri a katër gota, babai erdhi në qejf.

— Të ngremë një dolli, bir, — më tha, — për atë Barinë, sekretarin e organizatës bazë, për atë Gurin, Mustafanë, Bexhetin... se, nuk janë këtu e nuk na dëgjojnë, por e vërteta është që të janë bërë krahë, dhe me ta... Se të them unë, or bir: vetëm, zjarr të bëhesh, s'ke q'bën.

— E di, baba, — iu përgjegja pa e shpurë fjalën gjer në fund, me një mënyrë si t'ja prisja shkurt: — ti e ke parë se unë më shumë vlerësoj ata. Dhe ai, duke tundur kryet:

— Po, po — më tha. Pastaj u krekos dhe vazhdoi: — Ngreje dhe një herë ta pimë këtë për Partinë. Si thanë ata delegacionet e huaja kur erdhën dhe panë tarracat tonë: «Vetëm duke parë një tarracë e jo gjithë këto tarraca, njeriu do të

mendonte se më i fundit këtu në Shqipëri është më heroi». Me partinë u bënë këto, or bir.

Nuk do t'i përfundoj shënimet e kësaj dite pa thënë diçka edhe për nënën. Ah, nënë, nënë! Gjithshka të mirë e të bukur që mund të kem në shpirt, shkëndijën e parë të asaj të mire dhe të bukur ma ke ndezur ti. Nënës, tek e shihte babanë ashtu si fajtor ndaj meje, nuk iu ndejt pa u shkrehur, duke e mbrojtur atë ashtu siç dinte ajo, për sjelljen e tij, për pritjen e ftohtë të natës së parë, kur u ktheva në fshat:

— Pi, pi aty, mos folë. Se e dimë që ti di më shumë, dhe ke rënë nga të shtatë degat!

HIJA E ZEZË E «EFENDIUT»

Në portën e jashtme u ndje një e trokitur e shurdhër, por shumë e njojur për Hyrijen. Erdhi përséri «I nxirosuri», tha me vete dhe ungrit të shihte nga dritarja në ishte ai vërtet apo jo.

Mulla Ziguri, hoxha i fshatit, po hynte brenda, sikundër e kish zakon, pa pritur të delte njeri ta ftonte. Si njeri «me edukatë», për të mos e gjetur të zonjën e shtëpisë pa fshirë e pa rregulluar, ecte ngadalë nëpër oborr; kollej pa pasur kollë e shtirej sikur vonohej, sepse i tërhiqte vëmendjen diçka. «Prapë e prure kokën, mos e prufsh!» mallëkoi nëpër dhëmbë Hyrija sa me urrejtje për të, aq edhe me frikë. «Pse e qas në shtëpi këtë, nënë?!» i tha e reja dhe vuri re që sytë e së vjehrrës qenë kredhur në një brengë të fshehtë. Kjo gjë asaj i kish rënë në sy që prej disa muajsh, por sot rrudhat e dhembjes e të hidhërimit të plakës i pa në një dritë të re. «Ah, moj nuse, moj bijë», iu përgjegj Hyrija, «ç't'i bëj të nxirosurit!?.» «Ç't'i bësh?! Mos e qas!» foli prerë Drita. Zigur efendiu trokiti edhe një herë te porta e brendshme, u koll, dhe hyri në korridor «gjithë edukatë», i qetë e i përvojtur.

— Ku të kam, motra Hyrije?

Ja pér këtë përvojtje të shtirur, pér këtë zë të butë, të zvargur, pér fytyrën gjoja prej shenjtori, plaka e urrente më shumë, por që, duke ndrydhur urrejtjen e saj, mundohej, gjithë frikë ndaj atij njeriu, ta nderonte sa të ishte e mundur më shumë.

— Këtu jam, efendi, këtu. Urdhéro.

Doli, i mori shkopin me dorezë të kthyer, ja vari në një gozhë dhe i priu pér në dhomë.

Zigur efendiu hyri duke përsëritur: «marshalla! marshalla!» Asgjë të veçantë nuk kish në shtëpi pér këtë «marshalla», por efendiu, pér t'u bërë qejfin të zotërve të shtëpisë, e kish zakon, kudo që vinte, të bënte «marshalla». Kështu, mendonte ai, u hynte sa më shumë në zemër njerëzve e i bënte pér vete. «Plaç edhe ti me gjithë «marshallanë» tëndel!» shfeu Hyrija duke i rregulluar shiltenë të ulej dhe, në të njëjtën kohë edhe u pendua, siç pendohej gjithmonë kur e mallëkonte, se mos hynte në gjynah. Duke hyrë në dhomë, Zigur efendiu i mbeti «marshallaja» në gojë, kur pa Dritën në këmbë pranë trapezës, tek rregullonte kanën dhe gotat e ujit! Ai u druhej të gjithë të rinjve. Vizitat, e kish zakon t'i bënte kur të rinjtë e të rejat ishin në punë, që t'i gjente vetëm në shtëpi plakat e pleqtë. E mblodhi veten shpejt e shpejt. U përpoq ta dëbonte mërzinë që e shtypi në çast dhe iu drejtua Dritës me atë gjakftohtësinë e vet të shtirur:

— Marshalla! marshalla! Si je, bijë? Si je, evlat?

«Edhe gjarpëri gjakftohtë është, po helmin e ka të fortë», mendoi Drita tek e pa t'i përulej

asaj me atë zë e lëvizje «prej shenjti» dhe iu përgjegj pa e përfillur: «Mirë», pa pasur frikë se mos tregohej e paedukuar dhe pa kthyer as kryet ta vështronte.

Zigur efendiu, që u mat t'i jepte dorën e të përshëndetet me të, ngriu pér një çast në këmbë, i zbehur në fytyrë e duke mbajtur fryshtat. Pas taj shkoi e ul në shilte.

— Si je, motra Hyrije? Si m'i ke evlatët?
Drita doli nga dhoma.

Efendiu vazhdoi duke vështruar nga dera që u myll:

— Të rinj efendëm, të rinj!

— Ç'ta bëri mirë, — tha me vete Hyrija. Dhe atij me zë: — Po, po, efendi, ç't'i bësh! — ngriti supet. — Do të vinë edhe ata në din, do të vinë.

— Po, po, po! — përsëriti efendiu.

* * *

Zigur efendiu kishte dhjetë vjet që kishte vajtur në katundin Sharkë, por gjer para katër muajsh nuk pat shkelur në shtëpinë e Hyrijes. Këtë gjë e kishte peng në zemër, sepse ishte një ndër ato shtëpi që nuk kishte hyrë e «nga s'kishte parë hair», siç thosh ai me vete. Përveç kësaj, kjo gjë sikur ja ulte edhe vlerën në sy të të tjerëve ku kishte gjetur grazhd e kulloste. Para katër muajsh, Adili, djali i Hyrijes pati shkuar në një kurs në Tiranë. Me të mësuar këtë gjë, Zigur efendiu mori shkopin në dorë dhe çantën prej doku të mbushur plot qitapë në krah, të cilët as dinte t'i lexonte, as dinte g'ishin dhe shkoi e trokiti në portën e Hyrijes. Me një buzëqeshje të rreme e

të neveritshme si dhe sot, krejt i përulur, gjithë dashamirësi të shtitur, gjithë gatishmëri për të qenë në shërbim të njerëzve, shkoi u ul po në atë kënd ku u ul dhe sot, dhe zuri të bisedonte me Hyrijen për frikë zoti e perëndie, për të vdekurit e shpirtërat e tyre, për nevojën që kanë ata në atë jetë për t'u dërguar ndonjë selam e për t'i kujtuar kohë më kohë me një atme apo me një jasin, sepse ashtu si kundër kanë nevojë të gjallët këtu në këtë jetë për letra nga të largëtit, po ashtu kanë nevojë edhe të vdekurit për t'u dërguar atme ose jasin. Efendiu e kishte marrë vesh se Hyrijes i kishin vdekur dy djem. Që në vizitën e parë ai mundi ta bindë lehtë - lehtë plakën fetare që hoxha t'u këndonte nga një jasin dy djemve dhe burrit të vdekur. «Atmeja bën pesëdhjetë lekë»; i tha Zigur efendiu plakës, «jasini njëqind». Po me jasin, atyre që kanë kaq vjet pa u kujtuar, do t'u qetësohen më mirë shpirrat». Dhe Hyrija nxori dhe i dha treqind lekë fshehura nuses. Kurrë nuk e kishte bërë këtë kob në jetën e vet, të nxirrte nga shtëpia qoftë edhe një majë gjilpëre fshehur djalit e nuses. Kjo e tronditi shpirtërisht dhe ndërgjegjja e saj mbeti gjithmonë e vrarë. Po ta hetoje, dukej si një njeri që i kish hyrë dhembja në shpirt dhe pyeste me vete: «Si e bëra unë këtë gjë prapa krahëve të djalit e të nuses?!». Në vizitën e dytë, Zigur efendiu i pruri lajmin për jasinin që u kishte kënduar të vdekurve të saj dhe e pyeti në se i kish parë në ëndërr apo jo, duke e vështruar me dy sy plot të fshehta, e si t'i kanosej me të butë: «shiko, mos më fshih gjë mua, se unë i di të gjitha!» Asaj vërtet i ishin

shtirë dy herë në èndërr gjatë atyre ditëve djemtë dhe burri dhe ja tregoi efendiut. Efendiut qeshi pa e fshehur kënaqësin e fitores së vet, vuri gishtin e madh në gojë, kafshoi thuan me dhëmbë dhe pastaj mbeti pér një copë herë të madhe me sytë nga tavani me një vështrim të habitur si ata njerëzit që janë përpara një problemi pa zgjidhje. «I nxirosuri ç'po bën kështu?!» pyeste me vete gjithë frikë Hyrija, dhe që atë ditë ajo me vete, nuk e quante as në emër as «Efendi» pér shkurt, por «I nxirosuri». Efendiut hoqi gishtin e madh nga goja më në fund, diç prapsi me dorë duke goditur në ajër, dhe pa me ngulm Hyrijen. Asaj iu drodh zemra. «I nxirosur, ç'do të më thuash?!» pyeti me vete plot frikë duke i shkuar menjëherë mendja te djali që kishte larg. Efendiut e vuri re, plaka pa qartë kënaqësinë që ndjente ai kur e trondiste kaq shumë. «Çfarë njeriu je ti, mor i nxirosur!» tha me vete. Zigur efendiut, që i kishte folur edhe pér xhinitë e shpirtat e këqinj, tundi kryet si patë keq, si njeri që ka në dorën e tij gjithshka të dukur e të padukur në dhe e në qilli. «Hëm», ja bëri gjoja me keqardhje të thellë, «thirra ato mjalt e qumësht...»¹⁾

— Pastaj?! - pyeti plaka duke e kapërcyer pështymën me zor.

— Ti paske nusen me barrë?

— Po.

Zëri i plakës u drodh në fillim e pak nga pak po i mekej fare. Duart po i dridheshin dhe rën-

1) Kështu i quajnë xhinitë pér t'i marrë më të mirë.

doi me bërryla mbi gjunjët e vet tē dobët.

— Ajo paska dështuar një herë?

Plaka nuk po mundej t'i përgjigjej. Efendiu nuk kishte nevojë ta dëgjonte prej gojës së saj. Gjatë dhjetë vjetëve ai kishte mësuar pér tē gjithë fshatarët edhe ato që ata nuk i dinin as vetë.

— Nusja jote... — vazhdoi efendiu me një qetësi tē tillë që plakën e mjerë e bëri, po tē mos kishte frikë nga tē fshehtat që fshihnte në lëkurën e tij, t'i hidhej në grykë, ta mbytte e tē mos e dëgjonte fjalën e madhe që do tē nxirrte nga goja. — Nusja jote, — tha ai, — prapë do tē dështojë. Ajo nuk do tē bëjë kurrë fëmijë tē gjallë.

— I nxirosur, c'më the?! — thirri atëhere plaka pa e përmbajtur veten, dhe e penduar u zgjat e i vuri dy duart tërë rruudha mbi gju. — Aman, efendi! Si tē mos mbaj unë korba një fëmijë tē djalit në prehër? Tē atij Adili, që siç e di, e kam një shkëndijë tē vetëme?!

— Nusja jote, kur ka qenë me barrë në fëmijën e parë, ka shkelur mbretëreshën e xhinive dhe mbretëresha e xhinive ka dështuar. Nga kjo, fëmijë në barkun e sat reje nuk do qëndrojë.

Plaka dukej sikur nuk po e dëgjonte më. Dridhej.

— Po mos u tremb, — u nxitua hoxha t'i fliste me besim në vete, — mos u tremb, se ka perëndia, i kemi në dorë edhe ato mjalt e qumësht.

— Efendi! — thirri Hyrija duke hedhur vështrimin sikur kërkonte me sy diçka nëpër dhomë.

— Ka perëndia, ka perëndia — e qetësoi efendiu. Pastaj, bashkë me plakën, shkuau në oborr. Hyrija e pyeti Zigur efendinë tri herë me rradhë:

«Ç'bën aty?». Efendiu, që kishte zënë me dorë një degë kumbulle; iu përgjegj po tri herë:

— *Unë tund degën,
Dega të tundij pemën,
Pema të tundij dhenë,
Dheu të tundij detin,
Deti të tundij mbretëreshën e xhinive
E t'i thotë t'ja fali Dritës
Gjynahun e fajin që ka bërë.*

Tek dëgjonte, plaka përsëriste me sy të zhga-berryer e me nderim, nga frika që i kish shtirë në zemër:

— I nxirosuri! Nga i di gjithë këto?!

I dha njëmijë lekë Zigur efendiut për këtë «nder të madh që i bëri». Por megjithatë i dridhej misht kur e kujtonte dhe nuk donte ta shihte me sy. Nga dita që «I nxirosuri» kapërceu pragun e shtëpisë së saj, ajo kishte humbur gëzimin, qeshjen, fuqinë, dritën. Or' e çast i suleshin mendime të këqija, të cilat ishte e pazonja t'i përzinte: «Po sikur «I nxirosuri» të zëmërohej kuschedi përse e t'i bënte ndonjë magji nuses, djalit, asaj, gjithë shtëpisë e t'u fillonte ndonjë prapësi, ndonjë kob?!» Fjalët dhe zëri i tij i bëheshin tek i dëgjonte: «Unë tund degën...» Ai nuk ishte ashtu zemërbutë, i dhembsur, shenjtor siç hiqej. Hyrija këtë e kishte parë qartë kur asaj po i fluturonte mendja nga frika për moslindjen e nuses, dhe atij i endej buzëve buzëqeshja e akullt e ujkut që ka vënë delen ndër këmbë. Lidhjet e fshehta me të prapa krahëve të djalit e të nuses e tmeronin edhe më shumë. Ç'do të thoshin djali e nusja, po t'i dinin të gjitha këto? Ata nuk besonin,

por ata ishin më të lumtur nga ajo. Digjej nga dëshira që të kish një njeri të zemrës, t'ja qante hallin, t'i hapte zemrën e t'i thosh që ajo po vidhte shtëpinë e po mbushte xhepat e hoxhës me para, po hiqte nga dhëmbi i djalit gjalpin, djathin dhe po ja hante «I nxirosuri», sepse Ziguiri i kish thënë se, që mbretëresha e xhinive t'ja falte fajin së resë, magjia që kishin bërë në oborr duhej përsëritur, gjersa mbretëresha ta lajmëronte atë me anën e hysmetçive të saj.

* * *

Koha e mbarimit të kursit që po bënte Adili në Tiranë po afronte. Për tri javë ai do të kthehet. Atëhere do të mbaronte për Zigur efendinë edhe mjelja e lopës së majme, siç e quante ai Hyrinë, prandaj erdhi sot për të fundit herë, por u bë për të ngrënë veten me dhëmbë kur pa Dritën brenda. Një gabim të tillë nuk e pati bërë gjékundi. Atje ku i shkisnin këmbët, hetonte mi-rë, pastaj shkonte trokiste në derë. «Përse t'i qëllonte kështu sot? Përse t'i iknin nga dora gjalpi i Hyrisë, mielli?... Drita, i thanë, ishte në punë!...»

Hyrija vuri re që efendiu po rrinte në shilte si të ishte ulur mbi ndonjë minë dhe kohë më kohë pyeste: «Aty është nusja?», «Matanë e ke nusen?» Nuk i foli për asgjë Hyrijes. Përpinqej të fshihte frikën që i kishte hyrë në bark, por për atë që nuk ja thosh goja, e tradhëtonin sytë. Ndejti fare pak dhe duke u bërë më baltë se ç'bëhej me shenjtërinë e vet të neveritshme, u ngrit e iku. Hyrija e përcollti gjer te porta jashtë.

— Nënë, — i tha Drita Hyrijes kur u kthyesh, — mos e qas atë kurrë. Ai është i poshtër, kusar,

gënjen njerëzit e çfarë nuk u merr. Të ka ardhur ndonjë herë tjetër?

— Uu, jo bijë, jo. Ja, vetëm sot, — tha plaka duke u ulur gjoja për të ndrequr rripin e nallaneve dhe nxitoi të hynte në dhomë. Por edhe vëtë e kuptoi se zëri i saj fliste qartë që ajo kish vepruar prapa krahëve të së resë, prapa krahëve të djalit që kishte lënë atë dhe nusen e re për të mësuar, që kur të kthehej prapë në fshat, të punonte për të fituar bukën me djersë dhe për t'i shërbyer sa më mirë kooperativës dhe familjes.

Hyri në dhomë dhe duke shkrepur urat e zjarrit që të ndizeshin, po mallëkonte me vete për hoxhën: «I nxirosuri, nga e pruri kokën! Kush u bë shkaktar e na e pruri në fshat, mos paftë ditë të bardhë!» Në këtë kohë erdhi Drita. «Nënë, — e pyeti, — në qoftë se të ka gënjerë edhe ty, nxirrja të gjitha në mbledhjen e fshatit. Ai nuk e di, por fshati i gjithë është ngritur në këmbë dhe do ta përzënë me daulle, si i thonë një fjale».

— Bijë, — thirri plaka duke iu dredhur buza, — kam frikë për ju! Për Adilin! Për ty!... Për!... — ajo e vështroi të renë nga barku, e drithëruar për foshnjën që priste ta rritte në prehër. — Ai mbledh xhinitë, të përmbyss shtëpinë, i vë zjarrin botës!...

E reja qeshi me të madhe.

— Ai është rremall, moj nënë. Ja ke për të parë ç'do t'i bëjë fshati atij dhe ç'ka për të bërë ai nga ato që beson ti. Ai ka qenë një birko dembel, hajdut pulash, dhe erdhi këtu...

Tri ditë më vonë, në mbledhjen e fshatit për

të përzënë Zigur efendinë, plaka e shkretë dëgjoi shoqet e veta si i kish rjepur «I nxirosuri». Dëgjoi edhe ç'maskarrallëke kishte bërë përpara se të vinte në Sharkë e të paraqitej si hoxhë. Priti plaka mos efendiu thërriste xhindët e i çmendte ata që i nxuarën në shesh të palarat, po asgjë s'po ndodhë. Priti mos i vinte zjarrin fshatit, por ai ish mbledhur sa një grusht.

— Këtij matrapazi i kemi dhënë bukë e ky na ka dhënë helmin, — tha një nuse e re më në fund fare. — Të ikij, të mos ja shohim bojën këtij xhambazi!

— Ashtu, bijë, ashtu, — tha me vete Hyrija.

— Kushedi, moj korbë, ç'do ta ketë rjepur «I nxirosuri» edhe tët vjerrë, prandaj më flet me aq zemëratë.

«I nxirosuri», me të mbaruar mbledhja, ngarkoi plaçkat dhe iku. Hyrija e ndoqi me sy si çapitej «i shenjtë» me kalin për dore, me atë kalë që e ngarkonte java - javën me të gjitha të mirat dhe i shpinte në shtëpi.

Pastaj u ngrit. Gjunjët i qenë mpirë, sepse ndënji shumë kohë e ulur në bisht duke përcjellë me sy «të nxirosurin», i cili tani u nxiros vërtet, kur ja përplasën turinje turpet e ndyrësitë që kishte bërë. Ajo qe e vetmja që e ndoqi me sy gjersa i humbi nga sytë si një njollë e errët, e neveritëshme, duke pritur me frikë mos ai bënte ferk dhe e përvëlonte fshatin, pasi të qe larguar. Po as kjo nuk ndodhi. Në vend të kësaj ajo shih-te fshatarët grupe - grupe, të rinjtë e gjëzuar që vinin në lojë hoxhën dhe qeshnin me të madhe me zë të lartë e plot gjallëri.

DJALI I MADH I RAMO KULLËS

Donte edhe një orë të errej. Përjashta ishte ftohtë, era të thante. Dëbora e parë kishte tri ditë që kishte rënë në vendet malore dhe, fill pas saj, pat bërë ngricë e madhe. Dilja, ulur në mes të vatrës, shtynte urat, që të ndizej më mirë zjarri, se i shoqi dhe djemtë vinin akull nga jashtë e, veç kësaj, fasulet ende nuk kishin zierë mirë. Me të ardhur, ata donin të hanin darkën, se ishin të lodhur gjithë ditën e do të binin herët për të fjetur.

Si u kujdesua për gjellën, ajo deshi të bënte ndonjë punë tjetër. Hodhi një vështrim rrëth e qark shtëpisë, si për të parë a për t'u kujtar se ç'punë mund të bënte, dhe sytë i vanë te një sini e mbushur me pjata, mbi magjen në fund të konakut. «Të ngrihem t'i fus në musandër apo t'i le tek janë?» — mendoi me vete dhe nuk po dinte si të bënte. I biri, Bashkimi, kur i kishte prurë para dy orësh nga dyqani i kooperativës, e kishte betuar që t'i linte sheshit, e të mos i fshihte. «Më mirë t'i shohë që sot babai», — i kishte thënë, — «sesa ndonjëherë tjetër. Sepse, si sot si ndonjëherë tjetër, ai prapserapë njëlloj do ta ngrejë sherrin. Prandaj, është më mirë që çka

për të bërë le ta bëjë sot». Mirë e kishte pasur djali me atë të tijën, por ajo nuk e duronte dot sherrin në familje. «Pa bukë le të jem», thoshte gjithmonë, «po veç grindje të mos kem në shtëpi». Ajo e kishte vdekje grindjen e të shqit me djemtë.

Bashkimi kishte blerë atë ditë pjata gjelle,ëmbëlsire, një pjatancë, lugë, pirunë, thika, dhe Dilja u qe gjuar atyre si të kishte hyrë në shtëpi ndonjë mall i madh. Por duke kujtar sherrin që do të bënte i shoqi, Ramoja, kur t'i shihte, iu prenë krahët. «Eh, ç'huqe të këqija ka edhe ai i uruar!» — tha me vete, «po, fundi i fundit, ç'do të bëjë? Do të cirret sa do të cirret e do të pushojë». Përpara syve i doli fytyra e Bashkimit, ashtu e ndritur nga gjëzimi, si në atë çast kur ajo i kishte thënë duke shikuar pjatat: «Kur të marrim nusen tënde, do t'i shtrojmë për herë të parë». «Është djalë», mendoi, «ka sevda. Edhe unë ashtu kam pasur sevda për gjëra të reja kur isha sa ai». Herë - herë gjëzimi që ndjente vetë dhe gjëzimi që kishte djali për ato sende, e mposhtte frikën që i lindte nga sherri i të shoqit, po herë - herë frika e mundëte gjëzimin dhe kjo ndodhë sa më shumë që afrohej koha e ardhjes së Ramos në shtëpi.

Kur ishte në këto mendime, «drang» u hap dera me forcë që prapa krahëve të saj, sikur ta kishte goditur furia e ndonjë ere të tërbuar, dhe Ramua u gjend në mes të konakut, duke çfryrë nga hundët si një ka i harbuar. Diles i vanë sytë menjëherë te mustaqet që i dridheshin.

Që kur ishte në zyrat e kryesisë së kooperativës, atij i kishin thënë për gjérat e reja që kish-

te blerë i biri dhe, që atje, qe egërsuar e qe bërë si i marrë. Sapo hyri në shtëpi, iu drejtua së shqes, duke i treguar sininë mbi hambarët:

— Po këto këtu ç'janë?! Ç'janë këto rrangulla?!

— Ngadalë, ngadalë, — iu përgjegj ajo, pa lojtur nga vendi, me fytyrën e kthyer nga ai, — ngadalë se djali i ka blerë; është i ri, ka sevda. E ç'u bë?!

— A nuk ju thashë se nuk dua në shtëpi nga këto gjëra? Kujt do t'ja shtroj unë? Apo të tallen mileti me mua?

— Jo, jo, nuk të tall njeri sot për këto. Iku ajo kohë! A je i zoti ta bësh shtëpinë shtëpi?...

— I zoti jam unë, po allafrëngat nuk i dua, se te ata miq e te ata shokë që kam nuk gjej allafrënga e nuk dua të më tallin. Shporrmi këto nga shtëpia!

— Jo, ato nuk i heq, se i ka prurë djali dhe i ka me sevda. Në s'të pëlqejnë ty, ti rri, ai i ka për vete.

— Jam unë zot në këtë shtëpi, e, sa të jem gjallë vetë, do bëhet si them unë! Atij, — e kishte fjalën për Bashkimin, — po nuk i pëlqeu, ja, hapur i ka të katër rrugët, nga të dojë le t'ja mbajë.

Bashkimi hyri në shtëpi fill pas të atit dhe, si e pa se qe egërsuar, qëndroi pas tij, pa bërë zë. Kur u kthyte i ati dhe e pa, atëherë iu ngrit më shumë ai damari i zi i ballit dhe e urdhëroi, duke i treguar pjatat:

— Merri! Hiqi! Shporrmi nga sytë!...

I biri nuk i foli, por shkoi e u ul afër këndit dhe i yuri shpatullat murit.

Gjakftohtësia e tij e çmëndi më shumë Ramon dhe, duke e shtytur sininë me forcë, bërtiti:
— Hiqmini nga sytë, ju thashë!

Pjatat, siç qenë vendosur njëra mbi tjetrën, ranë disa, dhe, nja tri a katër, u bënë copë, në mes të konakut.

Bashkimi kërceu vetëtimthi më këmbë e qëndroi në vend, duke vështruar nga copërat e pjetave të thyera, me sy të trishtuar e vetulla të rrudhura, si të shihte të thërrmuar ndër këmbë lumi-terinë e vet. Fytyra i qe bërë e bardhë si gëlqerja në mur. Në atë kohë Dilja iu drejtua Ramos që ishte ulur në kënd:

— Po ç'ke mor i zi që bën kështu, ç'ke? Ç'ke që nuk ua qesh buzën fëmijëve?!

Ramoja, duke trazuar urat me inat, nga që nuk dinte ç'të bënte tjetër, shfrynte:

— Poooo... Poooo... do t'i mburret nuses ai! Ç'na duhen në këto allafrenë?! Kujt do t'ja shtrojmë?!... Ç'na duhen ne këto të trasha?!

Atëhere Bashkimi e hapi gojën:

— Në i kam marrë për t'iu mburrur nuses, kurrë mos u martofsha, dhe kurrë mos u trashë-gofsha.

Dhe i tha kaq me zemër këto fjalë, sa që eëma u tremb, i hodhi duart në qafë të birit, e pushtoi dhe ja plasi të qarit;

— Mos bir, mos shpirt, mos fol ashtu!

Fëmijët e tjerë më të vegjël: Shega, Nikja, Xakja po rrinin të hutuar e të trishtuar, sikur të kishte ndodhur ndonjë gjëmë e madhe atë natë në shtëpinë e tyre.

Pas pak Dilja u ngrit, shtroi sofrën në hesh-

tje dhe i ftoi të shtëpisë, duke u ulur vetë e para:
— Ngrihuni, hajde hani bukë!

Zëri i saj ishte si një ankim kundrejt të shqit: «helm është kjo, nuk është bukë!» Të gjithë u shtruan të hanin darkë përveç Bashkimit, i cili, me gjithë të luturat e së emës, nuk deshi të ulej në sofër.

Ramo Kulla hante me oreks, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Avulli i fasuleve të ngrohta me mish ja shtonte më shumë shijen e asaj darke dhe përtipej me të dyja bulçitë plot, pa vështruar as nga fëmijët, as nga e shoqja. Për atë ishte njëlloj, sikur ata të mos ishin aty fare. Diles, nga dhembshuria për Bashkinin, iu lidh buka. Fëmijët e tjerë kishin uri, por hanin si me droje, sikur të kishin frikë mos i paditte kush. Si t'u hahej atyre kur vëllai i madh, që e donin e i don-te aqë shumë, po rrinte pa darkë nga dëshpërimi?!

Bashkimi qe ëlur në këndin nga e majta e oxhakut, i kishte vënë këmbët zjarrit e po mendohet. «Ah», psherëtit, «me këtë është zor të punosh» dhe shtoi me vete: «Sot ta kisha patur në shtëpi komisar Luanin, ta shihte vetë me sy se cili është im at dhe t'i thosha: «urdhëro e puno me të, shoku komisar, se po ua lë juve ta bindni». Në këto çaste, kujtimet e çuan në dhomën kulturnale-arësimore të kompanisë. Rreth mureve të saj lexoi parulla si këto: «Ushtari duhet të stërvitet në kohë paqeje si të ishte në kohë lufte», «Artileria është zot i luftës». Ja, atje afër dritäres, qenë varur skema qitjeje artillerie, skica të llojeve të ndryshme të predhave; ja edhe tabela e madhe me zotimet e kompanisë në një krah tjetër të

murit... në tabelën e luftëtarëve të dalluar, fotografia e tij... Dhe, në tavolinën, në krye të sallës, nga dera e hyrjes, iu bë komisar Luani tek u flet; «...Në fshatin tonë ka akoma shumë zakone të dëmshme: në shumë familje e zbrasin gjellën në një sahan të përbashkët... hanë me të ngjyer kafshitën... thelën e mishit e lëshojnë në sofër... flenë keq; në disa familje nuk mbahet higjena e duhur... Por ju që jini të rinj, që patë në ushtri shumë gjëra... ju duhet ta ndryshoni nga rrënjet mënyrën e jetesës në familje...» Dhe kur disa nga luftëtarët i kishin folur për kundërshimet që gjenin nga prindërit, midis tyre edhe Bashkimi, komisar Luani u kishte thënë: «Duhet të punoni me ta. Po të dini ju si t'u flisni, t'i bindni, nuk është e mundur t'u ndalojnë; njerëzit tanë e duan të renë, përparimtaren, veç duhet të dini të punoni me ta, kjo ka rëndësi.» Bashkimi vuri buzën në gaz e përsëriti me vete: «Urdhëro, shoku komisar, puno me tim atë!» Po në atë çast prapë iu bë si të dëgjonte fjalët e Luanit: «Edhe guri që është gur, gdhendet, e jo njeriu, veç duhet durim». «Po ç'durim të kem?» — mendoi Bashkimi i lënduar në shpirt. «Ja, i prura me aq gjësim pjatat, lugët, pirunët dhe po prisja darkën me gjësim që të hanim qysht sonte me pjata, kurse ai!...». Dhe prapë ftyra e tij plot shprehje zgjuarsije, u errësua: «Nuk duhet të ziherimi me prindët, nuk duhet të krijojmë sherr në familje pér jetën e re që do të krijojmë, por t' i tërheqim në rrugën e re me bindje...» — përsëriste porositë e komisar Luanit e, sikur ta kishte aty përparrë syve, filloi të hahej me të: «Si të mos

krijosh sherr me këtë kokë që ka ky?! S'dëgjon koka e tij as me të mirë, as me të keq».

Ramua mbaroi së ngrëni, hoqi shaminë e madhe, që mbante ngjeshur për brezi, fshiu buzët me të dhe, duke u tërhequr praptazi, shkoi te këndi e, pa ngritur sytë, foli me vete, po që ta dëgjonin e shoqja dhe i biri:

-Ato para që muarëm nga ndarja e prodhimeve të mos prishen. Le t'i kemi ca para aty mënjanë. Nuk na duhen ne ato të trasha: krevate, perderë, penxhere me xhamë... Pse, kujtoni se nuk i marr vesh unë ato që kurdisni ju prapa krahëve të mi?!

«Nuk paska qenë vetëm shkaku i pjatave që është bërë kështu, si ka i tërbuar, — mendoj me vete Dilja, — po kush do t'ja ketë thënë vallë?» — dhe vështroi nga Bashkimi. Ai e pa në sy e ngri-ti supet si t'i thoshte: «Ku e di unë kush ja ka futur në vesh?»

Ramoja vazhdoi:

— Po u bënë ato gjëra në shtëpinë time, o unë, o juve këtu. Se, pa u bërë akoma ato gjëra, dhe po tallen me mua njerëzia.

Atë ditë, duke punuar në zhveshjen e misrit, Ramon e kishte fjalosur Murat Zhupa, se si disa nga rinia e fshatit, midis tyre edhe Bashkimi, do të bënин shtëpitë model, si në qytet. Për këtë punë do të vinin disa gra nga qyteti, që t'ua pregatitnin për herë të parë.

Bashkimi, pa u shkëputur nga kujtimet e jetës, aq të gëzueshme, që kishte kaluar në ushtri e që i jehonin në zemër, po mendohej, kur gjëmoi zëri i të atit që iu drejtua vetëm atij:

— Dëgjove? Ty të them! Po u bënë ato që dëgjova sot, të ikësh nga shtëpia! — Dhe bëri një vijë në ajër me gishtin tregonjës.

— Unë nuk kam ku të vete, o baba, — i foli Bashkimi duke e mbajtur me zor gjakftohtësinë. — Kjo është shtëpia ime. Dhe ndonjë të keqe nuk po të bëj. — I ra tullës së vatrës me dorë dhe përsëriti me zë të kthjellët: — Kjo është shtëpia ime!

Ramoja ndjeu për një çast si po rrrokullisej hija e tij prej babai nëpër një greminë. Çakërriti sytë, lëvizi shpatullat e tundi kryet, si të shkundte diçka e të pregatitej për kacafytje dhe foli vetëm kaq:

— Oj!... Oj! Kështu, a?

— Po, po, kështu!

— Atëhere më thoni të iki unë e rrini ju në këtë shtëpi! — mbështeti të dy grushtet në dyshem, si të donte të ngríhej e të shkonte në atë çast, sepse nuk dinte ç'të bënte nga inati.

— Jo, as ti nuk do të ikësh, se nuk të lëmë ne. Ti me ne e ne me ty e kemi nderin, baba, — i tha Bashkimi. — Unë nuk po bëj ndonjë turp, mbushe mirë mendjen për këtë.

Dilja nuk po bënte zë. E sigurtë nga qëndrimi i djalit, se puna nuk do të shtyhej gjer në zënka, ajo po vështronë me sy përgëzonjës të birin, i cili, qysh se ishte kthyer nga ushtria, kishte marrë një hije burri të pjekur. Asaj i bëhej zemra mal kur dëgjonte që e thërrisin në fshat, e pyesnin, e nderonin, ja dëgjonin fjalën... Ja, edhe tani, i shoqi, nga i cili ajo qe dredhur gjithë jetën, nuk po di nga t'ja mbajë jo nga frika e të birit, po nga diçka që ajo nuk ja vinte dot emrin.

Bashkimi nuk deshi që atë natë, në atë gjendje aq të nevrikosur siç ishte i ati, të vëndonte kjo bisedë, por meqenëse i ati e hapi vëtë, ai e mori fjalën përsëri:

— Baba, — i tha, — sot kanë ndryshuar kohët. Njëherë e një kohë, në këto vendet tonë ishte për turp të bënte njeri odat me tavan, penxheret me xhame, të shtronte dyshekë e jorganë. Por ajo që ishte për turp dje, është për nder sot. Ne jemi thellë këtu në këto pyje e këto male, dhe mos shko më larg, po ja, gjer në Kashtaj, dytri orë që këtej, e do të shikosh sa shtëpi janë bërë me dysheme, me tavan. Ti ke të drejtë se as ke dalë as del, po, pa del një herë e shiko dynja me sy! pa del një herë e shih ç'bëhet! Ata që ndoshta të kanë qeshur sot atje ku zhvishnit misër, do t'i shohësh nesër, se edhe djemtë e tyre... Po ti vetëm një gjë të dish baba, së unë nuk po bëj ndonjë turp. Kur të kam turpëruar ndonjëherë?

Në këtë çast Dilja pati një dëshirë të papërbajtur e donte të ngrihej, të hapte dollapin e të nxirrte ato letrat e falënderimit që kishte marrë Ramua nga reparti ku pat shërbyer Bashkimi e ku shkruhej: «Komanda e këtij reparti ju falënderon për djalin tuaj që kini edukuar...» dhe t'i thoshte të shoqit: «Hapi sytë, or burrë, se nuk ke ndonjë zarbo në shtëpi, po ke një djalë që ta nderon qeveria dhe partia. Mos e ler me kokë ulur djalin përpëra qeverisë dhe partisë». Mirëpo ajo e dinte sa ja dëgjonte fjalën i shoqi, pranë heshti, duke thënë me vete: «Më mirë të lë djalin të hahet me të».

Atë që para disa kohësh e kishte parë si gjë të largët, por që ja pat pasur frikën, këtë darkë Ramua po e shihte si një të vërtetë që, sado t'i bënte qejfin vetes e ta mohonte, nuk e mohonte dot: I biri po merrte frenat e shtëpisë! Ai nuk ishte më në atë shtëpi vetë zot vetë shkop. Prandaj, ja donte qejfi që t'i zgjaste edhe më fjalët, për ta bërë të birin të bindej se sa të ishte gjallë ai, Ramoja, djali do të vepronë si t'i thoshte babai. Duke e pasur këtë dëshirë, ai vazhdoi:

— Me gjalljen time asgjë nuk do të ndryshojë në këtë shtëpi. Këtë nguleni mirë në kokë. Lušni të vdes unë dhe pastaj. . .

— Jo baba, ne kurrë nuk do të lusim të vdesësh, por të rrosh e të rrosh shumë që të na gëzosh e të shkosh pleqëri të mbarë, pleqëri me nder, si babai i tre djemve.

Ramua u ngrit përgjysmë i inatosur:

— Oh, më kënaqe ti i madhi mua, u nginja me nderimet e tua unë, nuk pres më nga të tjerët! — dhe tregoi me kokë Niken e Xaken e mbuloi kokën me gunë.

Kur binte të flinte, Ramon, me të vënë kokën në jastëk, e merrte gjumi, sikur ta kishte në xhep, sepse, vërtetë ishte inatçi i prapë, por nuk i bëhej vonë për çdo gjë që të ndodhë e nuk e vriste mendjen shumë. Kurse sot po ndodhë krejt e kundërtë. I biri, që ata dy-tre muajt e parë që pati ardhur nga ushtrija, iu vu punës dhe shtroi me dysheme, tavanosi dhe suvatoj njërin nga konakët. Për këtë ai e kundërshtoi, po jo edhe aqë, sepse tërë këto punë u kryen me marangozët e kooperativës dhe kujtoi se bëheshin

pa pagesë. Pastaj, nga një konak të tillë pothuaj se e patën bërë gati të gjithë në fshat. Të padurueshme pér të ishin këto allafrëngat që donte të sillte i biri në shtëpi. Ja ku u doli avazi atyre vajtjeve dhe ardhjeve të të rinxve e të ekipeve të grave që vinin nga qyteti. Atëhere Ramua as që pyeste pér ta e pat menduar: «Njerëz pa punë, vijnë e nxjerrrin bukën këtej nga fshati». Po edhe Nastradinin, kur ishte një ditë duke pregetit litarët, e pyetën: «Ç'bën ashtu, o Nastradin efendi?» Dhe ai qe përgjigjur: «Po i bie qemanes». «Ku e ka avazin qemanja?» e pyetën përséri, dhe ai prapë u përgjegj: «Nesër i ndihet avazi». Kështu vonë u ndje edhe avazi i atyre ardhjeve ngà qyteti dhe i atyre çfaqjeve që jepnin pér fshatarët, në verë, grupet që vinin nga qyteti. Mirëpo ky avaz ja çirrte veshët Ramos e ja ku po e linte tani edhe pa gjumë.

Vetë Ramua i kishte ndenjur të atit me dorë në zemër. Në sy të babait as gojën nuk hapte të fliste, as të shoqes nuk i pat folur e nuk e pat urdhëruar goftë edhe pér një gotë ujë. I mësuar të mendonte vetëm pér vete, vetëm pér bukë e pér asgjë më tepër, gjithmonë nën pushtetin e errësirës, nuk mund të pajtohej me ndryshimet në shtëpi, që pér të donin të thoshin shthurje, prishje e plotë qetësie, gjëra krejt të pahijshme. Me ato para që muarën nga kooperativa, po të ishte koha e parë, ai do të dëshironte të blinte ndonjë copë arë, a t'i vinte diku mënjanë. Mirëpo sot ai ka tokë sa të dojë, veç krahë të ketë të punojë. Atëhere le t'i kishin t'i ruanin në sënduq. Ato nuk kërkonin bukë. Po ja që del i biri i bë-

het plak shtëpie, duke qenë ai gjallë. Sigurisht që nesër, ai, kur të martohet, edhe nusen do ta nxjerrë allafrënga dhe kjo për atë ishte vithisja e shtëpisë dhe e nderit të tij. «Këto mustaqe», tha me vete nën gunë, «nuk janë turpëruar ndonjëherë, po ja që djali do të m'i turpërojë». Si të bënte? Të ndahej nga djali? djali ja tha copë që nuk ndahej prej tij. Të ankohej për djalin? ku të ankohej? Në këshillë? Këshilli ishte ai që i shtynte urat për kësi punësh. Në parti? Partia djalin e tij e kishte mbi krye e sipër. Sekretari i partisë i kooperativës kushedi sa herë i kishte thënë: «Bashkimin tënd e kam krah të djathë, o Ramo». Kush do t'i jepte hakë Ramos? Zalua i Dike Vloshit? po vetë Zalon nuk e pyeste i biri e jo më të tjerët në fshat. Më në fund vendosi: do të ikte vetë nga shtëpia, do të shkonte punëtor krahu. Me ato para që do të nxirrte, do të hante e do të vishej; në do t'i tepronte gjë, do t'i ruante t'i kishte për vete, dhe djali me gjithë të shoqen veten le të vrisin, le ta ndryshonin shtëpinë si të donin. Megjithatë, do të shikonte njëherë si do vinin punët më tej. Bashkimi sapo i kishte thënë: «Ne me ty e kemi nderin». Mund që të heqë dorë. Po jo, ai nuk i tha: «Epo mirë, o baba, kur s'të pëlqen ty, ja edhe ne po heqim dorë.» Ai nuk i tha kështu. U pa kjo punë, plak shtëpie nuk ishte më Ramua. Edhe Dilja ishte bërë me djalin tanë. Në sytë e saj ai kishte kohë që e shihte qartë mburrjen, se asaj i u rrit djali tanë e ai, Ramua i dikurshëm, këtej e tutje nuk do të guxonë më të sillej me të sikundër që sjellë. Ky mendim e egërsonë më tepër, sepse imë të vërtetë edhe

pushtetit tē tij ndaj gruas i kishte ardhur fundi. Duke shfryrë me këtë zemërim që i vlonë në kraharor, thoshtc herë pas here: «Po pse, çfarë jam unë, kufi në ferrët, a? Pa tē shohim ç'do tē bëjnë nesër e tutje?».

Ndërsa Ramua ziente me vete, si ai gjarpëri nën gur, Dilja në mes tē vatrës e Bashkimi në kënd diç pëshpërisnin. Ramua mezi dëgjonte ndonjë fjalë tē shkëputur.

Më në fund dëgjoi Dilen që i tha tē birit me zë pak më tē lartë, se kujtonin që Ramon e kish-te zënë gjumi:

— Ha dy kafshita bukë, t'u bëftë nëna, se më je lodhur. Nata është muaj tanë, nuk gdhihesh dot pa ngrënë.

Pastaj u ngrit, i zbrazi gjellën e ja vuri djalit përpara. Nga tringëllima e enëve, Ramua e kuptoi se ajo i kishte zbrazur gjellën në pjatën e re e ai po hante me lugë tē hekurt. Kur po hante bukë i biri, Ramua dëgjoi Dilen që i pëshpëriti: «Sa tē bukura!» e kishte fjalën domosdo pér pjatat, lugët e pirunët. «Mos u dëshpëro, tē keqen nëna, nesër shko bli katër pjata tē tjera e bëji prapë dymbëdhjetë. Nuk u bë ndonjë kjamet. Ç't'i bësh? Unë me këto huqe e kam duruar një jetë tē tërë».

«Jo xhanëm!» shkrofëtiti atëhere nën gunë Ramua. «Ka mbaruar kjo punë. Unë tanë sapo i theva pjatat e ajo, si pér inatin tim, vete e m'i shtron darkën me ato pjata. E pse e bën këtë? Pér inatin tim! Po ç'jam unë këtu? Gur varri, a?» — I hipën xhindet në kokë e deshi njëherë ta flakte gunën tej e tē vinte t'i merrte pjatat e t'u

hynte bamp e bamp me këmbë, t'i bënte thërmia
të gjitha, mirëpo e përbajti veten, se e dinte që
i biri nuk do ta linte. Nga fuqia nuk ishte keq,
po megjithëse i qenë errur sytë, prapë mendoi se,
edhe me atë punë që do të bënte, nuk do të fi-
tonte gjë.

Të nesërmen Ramo Kulla u ngrit si gjithnjë
herët në mëngjez dhe shkoi nga tharqet e misrit.
Erdhën pas tij edhe të tjerë — të gjithë ata që ishin
caktuar të zhvishnin misrin. Siç qenë radhitur,
varg njëri pas tjetrit, Ramua qe ulur midis Zalos
e Kamberit. Kështu zinin vend si gjithnjë, sepse
ishin pothuaj moshatarë e u hahej muhabeti.
— Pse je mufatur kështu, o Ramo? — i tha
Zalua.

Ramua ngriti sytë dhe e vështroi, sepse
Zalua ja bëri atë pyetje me një zë sikur t'i thosh-
te; «E di unë ç'është bërë mbrëmë në shtëpinë
tënde, e di, po fjalosna e mos na fshih gjë».

— Jam me rrufë, — iu përgjegj Ramua shkurt.

— Ha, ha, — qeshi lehtë Zalua. — Ajo rrufë që të
ka zënë ty, ka zënë edhe të tjerë — Dhe nuk u
drojt se mos kjo shprehje merrej me dy kuptime.
Nga ana tjetër, ja bëri me sy Kamberit.

Kamberi hodhi në thesin pranë kallinë e
zhveshur të misrit dhe pastaj nxori kutinë e du-
hanit:

— Ta ndezim një herë, o shokë.

Të tre burrat dualën përjashta, prapa thar-
qeve, për të pirë cingaret.

— E kam keq me djemtë, — u hodh e foli Za-
lua si papritur.

— Ti mos u qaj kot se i ke akoma të vegjël,

dhe një herë u thua «sus» e pushojnë ata të tutë, po ç'tu bëjmë unë e Ramua tanëve! — ja priti Kamberi.

— Si është puna? — pyeti Ramua duke e kuptuar se të dy shokët diç donin të mësonin nga ai, por ai sikur të therej me gruan e me fëmijët, nuk i nxirrte të palarat e shtëpisë në lagje e në fshat.

— Pse bëhesh si i paditur? — i tha Zalua. — Po zjen i tërë fshati që shtëpia jote, e Kamberit, e Canes, e Files... do të bëhen *model*, a si i thonë?

«Që tani zunë të tallen me mua» mendoi me vete Ramua, «po më vonë, ç'do të thonë vallë?!» Shtërngoi dhëmbët fort, se nuk donte t'ua bënte qejfin bashkëfshatarëve dhe foli si pa të keq.

— Këtë e di, thashë se mos kishit ndonjë të re tjetër.

— Unë, për veten time. — vazhdoi Kamberi, — e kam bërë top: këtej e tutje nuk do të përzihem më në punët e shtëpisë, sepse edhe sikur të përzihem, nuk më dëgjon njeri.

Ramua e pati zili edhe në atë çast shokun e vet, ashtu siç i qe zilepsur gjithmonë për gjak-ftohtësinë e tij. E mori me mend që edhe në shtëpinë e Kamberit mbrëmë do të qe bërë ndonjë sherr, po sherr Kamberi: «Pse or djëm kështu?! Ç'u duhen juve këto?!» e jo sherr Ramoje, që kur i hipnin ato të shkëmbit, i zhuzhisnin veshët, si zhurma e lëvezhgave që bëhet në thark duke zhveshur misër.

Zalua e hiqte veten si më i gjykueshëm ndër ata të tre. Edhe kur bisedonin, në çdo rast, ai merrte qëndrim si kaposh mbi ta dhe fliste me një zë që donte të thoshte: «Unë di, dëgjomëni mua».

Për këtë Ramua e kishte pak zët, sepse sipas tij, Zalua ishte ca zemërlik, e sikur kënaqej kur shih-te fatkeqësi në shtëpinë e të tjerëve. Veç që nuk fliste, shumë herë kishte të drejtë e nuk thoshte fjalë për hava, po i gjente burimin qoftë së mirës, qoftë së keqes. Edhe sot Zalua tha ca fjalë me vend që Ramos nuk iu hoqën nga mendja. «Eshtë e kotë», u tha ai shokëve, «të hahemi me djemtë. Nuk eshtë faji i tyre. Tjetër hesap se ne u rritëm ndryshe e nuk na pëlqejnë ato që bëjnë ata. Por e vërtetë eshtë kjo: Kohët tani kanë ndryshuar. Djemtë dalin, shohin, dëgjojnë, dhe domosdo duan të bëjnë sipas kohës...» Dhe Ramua, pas këtyre fjalëve, mendoi me vete: «Mirë, me të vërtetë kohët kanë ndryshuar, po pse djali im të hidhet i pari e ta bëjë shtëpinë *model*? Dale, le të presë, të bëhen model pesë a gjashtë shtëpi të tjera, pastaj le ta bëjë ai. Po çoc i pëlqen atij të duket përpara fshatit. Pse të mos jetë as i pari as i fundit?»

Zhveshi misër, gjithë ditën, i ngrysur në fytyrë, me vetullat rrudhur e buzët lëshuar, duke harruar ku ishte e duke bërë gjyq me të birin e me të shoqen sikur t'i kishte aty përpara syve. I zhvishte e i flakte tej kallësat e misrit me inat, sikur t'ja kishin ata fajin. «Po, ai misër ja kishte fajin me të vërtetë, se që kur qenë bërë kooperativë, po rritej sa mezi e priste sopata, si i thonë fjalës, dhe njerëzit, duke mos ditur ç't'i bënин ato që u tepronin nga të ardhurat, ishin shtënë pas pjaturinave, pas perdeve nëpër penxhere e pas qelqurinave. «Pasuria të tërbon», mirë e ka thënë ai i pari».

Që atë çast, duke punuar, Ramua e vendosi që të mos qëndronte në shtëpi, sidomos, në ato ditë kur do të vinin nga qyteti ato gratë, që flitej në fshat, e që do të ndihmonin Dilen e tij me shoqë për të prerë e qepur perdera e mbulesa krevatesh. Ai e vendosi të shkonte nga e bija ndonjë javë se kishte pesë vjet pa dalë nga shtëpia. Pastaj, po t'i mbushej mendja, meqë fshati i dhëndrrit ishte ngjitur me minierën, mund edhe të qëndronte në minierë si punëtor.

Kështu siç e pat menduar edhe bëri. Tri-katër ditë para se të vinin ato gratë nga qyteti, bëri gati kalin, mori leje nga kryesia e kooperativës dhe u nis. Kur vajti tek e bija, pa që çdo gjë kishte ndryshuar. Atje fshati që bërë i téri si në kasaba. Atë darkë që mbërriti, i dhëndrrri ftoi dhe gjithë vëllazérinë. Kur erdhi darka, e bija shtroi pjata, lugë të hekurta, pirunj. Ramos i vuri një pjatë bosh përpara, për të vënë thelën e mishit dhe, kur ai, nga inati i së bijës e mori thelën e mishit me dorë dhe e lëshoi mbi sofër, e bija u skuq, u bë flakë dhe i kafshoi buzët se i erdhi turp nga mysafirët. Në atë kohë Ramoja deshi t'i shfrynte «Tyyt!...» e deshi t'i thosh pastaj një fjalë të rëndë, po s'mundi të hapte gojë se aty kishte edhe njerëz të huaj. Dy ditë pasi kishte vajtur aty, i hodhi një thumb të dhëndrrit:

— E paske bërë si në kasabatë, or Zake, po a je i zoti ta mbash këtë bujë, se këto balturinat e qelqurinat bëhen copëra e këto rreckat grisen shpejt? — As së bijës, as dhëndrrit nuk i tha se q'bëhej në shtëpinë e tij atje në fshat. Ditën e tretë ai shkoi në minierë, se, helbete, një

herë e mori rrugën dhe ishte mirë të takonte edhe bashkëfshatarin e vet, Kasëmin, që ishte shpër-
ngulur që gjashtë - shtatë vjet të kaluara. Kasë-
mi e mbajti me pahir për darkë. Sapo shkeli në
prak të derës, Ramua u habit me konakët e me
takëmet që kishte kurdisur bashkëfshatari i tij,
po ca më shumë u çudit kur u shtrua darka, me
të shoqen e çupat e Kasëmit, që flisnin e qeshnin
para miqve sikur të ishin burra e jo gra. «Hajde
dynja hajde!», tha me vete atë natë dhe shtoi:
«Ik or Ramo, ktheu shpejt në strofkullën tënde,
mos i bëj shamatë as djalit, as gruas, e as nuses
kur të të vijë në prag».

Dhe pas një javë, duke u kthyer për në shtë-
pi, sikur të kishte përparrë Dilen e Bashkimin,
fliste me vete: «Kini të drejtë. Bëni si t'u thotë
mendja, se me ç'më panë sytë mua, kështu qenka
e udhës tani e tutje, veç mos e teproni si atje te
Kasëmi.» Pastaj, duke menduar se sa do të ishte
i zoti ta duronte jetën allafränga në shtëpi, e
ngushëllonte veten duke përsëritur shpesh: «Unë
e hëngra kullotën tani».

ME «PLEQTË E PERONDISE»

Sapo ka aguar. Barin e njomë, lulet, gjethet i ka mbuluar vesa. Rrezet e para të diellit bien mbi pikat e vesës dhe toka, e veshur e tëra në blerim, ngjan si e spërkatur me gurë të çmuar, që vezullojnë. Në plepat, në të dyja anët e rrugës, zogj të panumërt cicërojnë kush e kush më fort, si të jenë në garë. Ndonjë bilbil i rrallë, si të mos jetë nginjur së kënduari gjithë natën, apo si për të përshëndetur diellin, ja hedh këngës thellë në shelgjet buzë pérroit.

Pranvera ka ardhur me tërë bukuritë dhe toka, e çlodhur gjatë dimrit, ka shpërthyer gjitë dhe nxjerrë thesaret si për të shpërblyer sytë e njerëzve të lodhur nga djerrinat, balta e zezë, retë e murme, shirat e dëndura.

Mbi të lashtat në kalli e sipër, fryn era e mëngjezit dhe ato, si një det i gjelbër, dallgë-zojnë. Arave të punuara zbardhin këmishat e burrave, shquajnë ngjyrat e shumta të veshjeve dhe shamive të grave. Ata mbjellin fidanet e fundit të duhanit dhe të perimeve, pambukun; janë në mbarim të misrit. Diku buçet një traktor. Në-për kanalet vaditëse duken njerëzit varg tek ulen,

ngrihen, e prapë ulen. Merren masa për thatë-sirën e verës.

— Tunjatjeta shokë, — përshëndet shkrimtari, Dëfrim Sokoli, që ka shkuar në bazë të njohë jetën dhe që këto ditë të bucura pranvere i ngjallën dëshirën për të bërë një përshkrim.

Dy pleq ngrihen dhe i japin dorën.

— Tunjatjeta e mirë se erdhe.

— Uluni, ju lutem, mos u ngrini.

— Jooo, kur vjen një kokë duhet të lëvizë një... — qesh me zgjuarësi plaku, që është duke gdhendur ca hunj.

— Si i thonë, si i thonë?

Plaku e përsërit prapë shprehjen dhe pyet:

— Pse nuk e ke dëgjuar ndonjëherë tjetër?

— Jo.

— E po sa do rrrosh do mësosh, — ja pret ai që zgjedh fidanet e duhanit, — kështu kanë thënë ata të parët.

Plaku që gdhend hunjtë quhet Ramis Zhuri, tjetri Gani Qosja.

— Përse u duhen ata hunj?

— I pregatisim për domatet, për të lidhur domatet pas tyre.

— Duhanin e mbaruat së mbjelli?

— Edhe sot e nesër kemi.

— Ju paskeni shumë fidane akoma, — thotë shkrimtari duke vështruar shtratet e nxehtha.

— I kemi për të shitur. I blejnë kooperativat malore. Zëmë çdo vit mijra lekë nga rasati i duhanit. Do një duhan fshati? urdhëro ndize një herë.

— Mos është i fortë?

— Ndize, ndize. Ganiu tërë jetën me duhanin

është marrë. Nuk mban kurrë duhan të keq. Era mollë vjen duhani i tij.

— Pse, i kooperativës jo? — nxehet Ganiu dhe vështron me inat.

Ramizi qesh nën buzë, vështron nga shkrimtari, i shkel syrin:

— E po atë që ke tëndin e ke zgjedhur si përvete. Si atë që bënje një herë e një kohë për bejlerët.

— Bejlerëve... — Ganiu u këput një të sharë me zemërim bejlerëve dhe nxehet keq me Ramizin.

Ramizi bën sikur nuk dëgjon. Pyet:

— Nga të kemi ty, or shok?

— Këtej nga Berati.

— Me se merresh? Ku punon?

— Në kulturë.

— Na fal ne pleqve, se ne jemi si ata pleqtë e njëhershëm të Perondisë.

— Ç'kanë qenë këta pleqtë e Perondisë?

— Pleqtë e Perondisë? Pleqtë e Perondisë, që thua zotërote, ishin dembela të mëdhenj. Dembela Stambolli, si i thoshin një fjale më parë. Rrinin gjithë ditën nën hijen e një rrapi dhe kushdo kallonte në atë kryqëzim rrugësh, e pyesnin kush ishte, nga vinte, ku shkonte, për ç'hall ishte munduar... Pastaj vihesin edhe në garë me shoshoqin, siç i thonë tani. Me të parë një njeri nga larg, bisëdonin: «Ky njeri ka një hall të tillë. — Jo, — përgjigjej tjetri, — ka këtë hall». — Kur afrohej udhëtari e pyesnin. Kush ta kishte gjetur se ç'hall kishte udhëtari që vinte, ai fitonte garën e të gjeturit me mend. Njerëz dembela, or bir. Ja, si puna jonë.

— Kush tha që jemi dembela? — u nxeh përsëri Ganiu. — Mbaje për vete atë fjalë.

Ramizi, siç dukej, ishte mësuar me shokun e vet të sertë.

— Kur të pamë ty, — vazhdoi të fjalosie shkrimtarin pa e turbulluar aspak gjakun e duke i shkelur përsëri syrin, — kujtuam se mos ishe nonjë i deleguar që të kishin dërguar për të shoshitur punën e mosmarrëveshjes që kemi unë e Ganiu me kryetarin.

— Ç'mosmarrëveshje kini?

Ganiu vështroi egër nga Ramizi, si t'i thoshte: «Mbylle mandallen!» Por nuk i foli. Vazhdonte të zgjidhte fidanet e duhanit e të lidhite trumbat.

Ramizi, gjithnjë duke gdhendur hunjtë, pa i ngritur sytë dhe duke lënë të kuptohej qartë se ai nuk shprehte mendimet e veta, po të dikujt tjetër, tha:

— Ja, ne jemi pleq. Nuk kemi më fuqi. Nuk dalim dot në punë. Mirëpo ku të lë kryetari: «Kemi plot punë për ju, kemi plot punë për ju». Dhe na e gjen nga një punë. Mbarojnë hunjtë së gdhenduri, «shko nguli e lidh domatet.» Mbaron edhe kjo, bie drapri, «shko ruaj duajt në lëmenjtë». Ne nuk duam, po ai me pahir.

— Jo me pahir! — kundërshton Ganiu. — Se po të mos dua unë, s'ka ç'më bën asnjeri. Po e di ç'thua? Ta ha kokën me të mirë ai.

— Ç'me të mirë! Ti je parë hëna jashtë me të që në krye.

— Që në krye, se ashtu ma bëri.

— Ç'të bëri? — pyet kureshtar Dëfrimi.

Ganiu heq qylafin, fërkon sheshin e kokës

tullace, si tē largonte mizat përdhese që andej
dhe duke ja lënë fjalën në gojë Ramizit, fillon:

— Që thua ti shok... Si ta thonë emrin zotë-
risë sate? Po, që thua ti shoku Dëfrim, kohë më
parë, më vjen një miku im në shtëpi e më thotë:
«Të dua çupën për Muharrem Prashkën». Mendo-
hem, bisedojmë, më në fund i them: «për hair qoftë.»

— Jo, po thuaji edhe sa vjeç ishte Muhaire-
mi, — nxitohet Ramizi. Ganiu e vështron vëngër
po s'e ndërpret dot. — Muharremi ishte burré i
ve, me tre fëmijë, rrëth tē pesëdhjetave. Mirëpo
këtij i erdhë tē émbla ato pesëdhjetëmijat.

Ramizi heshti. Edhe Ganiu nuk po fliste. U bë
heshtje për një copë herë.

— Pastaj? — pyeti shkrimtari.

— Le ta tregojë ai tani, — bëri me dorë Ganiu
pa ngritur sytë nga fidanet e duhanit.

— Tregoje vetë ti.

— Që thua ti, çupën do ta kisha rehat atje —
vazhdon Ganiu: — në kamje, në bollëk. Mirë po na
merr vesh kryetari, ma zë djalin «çycyçy e çycyçy»
ma ysht, m'ja bën mendjen veri. (Djali po që në
fillim nuk donte). Ngre edhe tërë fshatin kundra
meje kryetari, më bëjnë për pesë para me një fletë-
rrufe. Ngrihet edhe djali i dërgon lajm atij mikut,
pa më pyetur mua: «Ti nuk ke grua këtu, po shi-
ko punën». Dhe kështu, or bir, më lanë me turp e
kokulur. Ja, ai kryetari ma bëri këtë.

— E ke pasur shumë gabim ti xhaxha. Kanë
pasur shumë tē drejtë djali, fshati i gjithë, krye-
tari.

Ganiu ngriti sytë e vështroi duke thënë me
vete: «Ju tē gjithë një kokë kini». Pastaj me zë,

po si duke folur me vete përsëri: «Gabim, pa gabim, kjo punë ka kohë që ka ngjarë. Por unë ta kam fjalën që ndërhyr shumë ky kryetari ynë në punët e tjetrit».

— Pse, ku ka ndërhyrë gjetkë?

— Ku ka ndërhyrë pyet ky?! — Zëri i Ganiut u bë më i fortë. — Ku nuk ka ndërhyrë? Pyet më mirë. «Të bëni shtëpitë me tavan e dysheme! Të bëni penxheret me xhame! Të flenë bagëtia larg shtëpive ku rrini vetë! Të bëni krevate, dollape!...» Bie ca gra andej nga qyteti. Ato «çyçyçy» me këto gratë tonë. Bëj perde andej, pre rrecka këtej. Sill dhoga nga ndërmarrja, ngri skuadra tavan-xhinjsh...

— Pyete, pyete, — i thotë Ramizi Dëfrimit, — pyete Ganinë ku fle!

Ganiu e shikon me sy mospërfillës dhe nuk pret.

— Në krevat fle, gushe-gushe me plakën, e q'do të thuash ti?!

— Jo, — ja pret Ramizi, — po ca kohë më parë sikur të merreshin mentë në krevat dhe e ngrijë dyshekun e shtroje në dysheme dhe ditën e vendosnit përsëri në krevat.

— Ehu, ke llafe ti or vëlla, nuk ta dal dot ty unë! Ti ngatërron një fshat të tërë. Ti je me të vërtetë si ata Pleqtë e Perondisë.

— Po, domethënë, — ndërhyr shkrimtari, — ky kryetari i kooperativës tuaj nuk u marka me punët e bujqësisë, se nuk i mbetka kohë për këto të tjerat?!

— Ai ore?! Ai nuk ka kohë?! — flet me ironi

Ganiu. — Jo, or jo, se e gjen kohën ai. Pa shko kërkoje, e gjen dot në zyrë!

Ngrihet që në pikë të sabahut, që me kaponjtë e parë, dhe vete në shtëpi më njëmbëdhjetë të natës. Nuk e di unë, ka shtëpi ai njeri apo nuk ka. Merr vesh se është në Kuqicka, (kemi një sektor, kështu e quajmë ne) sa të vesh ti atje ta gjesh, ka ikur ai të ka lënë vendin, ka shkuar te brigada tjetër a kushedi ku mund ta gjesh. Tani të thonë: «Ja këtu e pamë». Pas pak merr vesh: «Ka shkuar kryetari në Berat». Kur i vete në zyrë në darkë, e gjen atje. Po kur vajti kur erdhi ky rop!

Pyet Dëfrimi:

— Ti xha Gani, flet me kryetarin, apo i mban mëri?

— Ku të lë ai t'i mbash mëri. Nuk dua t'i flas unë, jo, se nuk puqem unë me të hiç gjëkundi: «Punë!» thotë ai. «Dale ore, se shpirt kemi. Jemi pleq. Pa kemi edhe miq e shokë, duam të vemi e të na vinë». «Jo», thotë ai, «të vesh te miku, po jo pa shkak, jo pa sebep». «Ta bëjmë moderne jetën» thotë ai. «Moderne, moderne, po unë jam plak. Kështu më ka jetuar gjyshi, stërgjyshi, babai, vetë...» Mirëpo i ndes gjithmonë. Gjithmonë i ka shkuar gomari në urë, se ka bërë për vete tërë fshatin. Ai ka çmendur edhe shokët e këtij. — Ganiu tregon me kokë Ramizit. — Mirëpo, sado që s'i flas, ai vjen më hedh duart në qafë. «Dridhi këto mustaqe çile, xha Gani!» «Ikë», i them, «shporru nga sytë». Këtej më bëri proçkën, më prishi me atë mikun ku fejova çupën herën e parë, këtej

më demaskoi sekretari i partisë në mbledhjen e tërë fshatit, këtej më erdhi në shtëpi.

— Dhe ti e qase?

— Mos e qas po deshe. Ti e përzë nga dera, ai të hyn nga penxherja.

— Unë kam dëgjuar, xha Gani, se këtu, i tërë fshati betohen: pér kokën e Besnikut, pér kokën e kryetarit e s'ka tjetër.

— Ashtu mund të jetë, se daullet, sa më larg, dëgjohen më mirë, por betohen kokat si e këtij, — tregon Ramizin, — po jo unë, jo unë! Mua ai më ka prishur rehatin kurdoherë. «Të kemi specialist duhanin» më thotë, mirépo nuk ma dëgjon gjithnjë fjalën. Iu beson librave më shumë. Hëm më vë plak, hëm më rruan mjekrrën. Burrë i thonë atij! «Të mbjellim rasatin e duhanit në oxhakë të nxehjtë» më tha. «Jo», i thashë, «unë rasatin di ta mbjell si di unë». E mbjell, s'e mbjell, në fund e tija u bë se e tija.

— Mirë e ka pasur. Me oxhakë të nxehjtë fidanet rriten shumë më herët.

— Ashtu është, — ndërhyjn Ramizi. — Si hoqi dorë një mot, iu mbush mendja edhe Ganiut pastaj dhe ja, tani me oxhakë e rrit rasatin edhe ky, ka pesë-gjashtë vjet. Ra në ujdi me kryetarin.

— Jo! S'kam rënë në ujdi! Unë...

Ramizi e sheh se e ka kurdisur mirë Ganinë, qesh nën buzë duke gdhendur dhe herë pas here i fut nga një thumb.

— Po pse, edhe ti, nuk më the qëparë: «Të gjitha hallall ja kam bërë këtij kryetarit tonë, që kur na pruri dritat elektrike e radiot. Edhe nevrikllékun, edhe atë, edhe këtë; të gjitha ja kam

falur». Kur kërcet gërneta në radio brenda në odë dhe ti e dëgjon përjashta në oborr, si më the ti, si më the? «ti shkrihesh i téri».

— Dritat na i pruri Partia neve dhe radion ma bleu çuni mua.

— Ashtu éshtë, po ai kryetar brodhi gjer nga Qyteti «Stalin», Durrësi e Tirana; gjej këtu tel, bli atje çelësa, kërko këtej priza...

— Çalltis, çalltis, nuk them.

Toni i Ganiut ishte si toni i atij të mundurit, që nuk ka ku të mbahet më që të kundërshtojë.

— Pa shiko ç'berezet kemi! — Ramizi tregon arat me dorën që mban sqeparin. — Kemi kaq vjet që marrim gjithë ato lekë pér ditë pune.

— Sivjet bujqësia éshtë shumë e mbarë, se ka ngarë edhe moti, — kundërshton Ganiu.

— Moti ndihmon atë që punon. Pa rri ti duar-lidhur, pa të shohësh, — ja pret Ramizi.

Shkrimtari do të bëjë një shaka, përpëra se të ngrihet të ikë:

— Do ta takoj kryetarin, xha Gani, e do t'i them të të përjashtojë nga puna, se e shoh që ti pér këtë e ke mëri më shumë. E kam mik e do të më dëgjojë. Unë nuk kam ardhur pér kësi punësh, po meqenëse ju paskeni mosmarrëveshje...

Xha Ganiu ngre dorën në ajër e i thotë sa me zë, me dorë:

— Lere atë fjalë. Mos e humb fjalën kot! Po nuk qe në interesin e kooperativës, ai nuk dëgjon asnjeri. Ai nuk pyet pér veten e tij. Djali i digej zjarr e tym vitin që shkoi, ai e dërgoi djalin në qytet me të shoqen dhe vetë u gëdhi te maqina shirëse, se po vinte rrëth moti pér shi, dhe kishte

frikë mos e zinte shiu e valosej gruri. Po lere ti, lere, se kam fuqi edhe ca kohë unë. Pastaj, — plaku vë buzën në gaz, fytyra i merr një ndriçim të rrallë që i buron nga një krenari e ligjshme dhe gëzim i brendshëm, — duhet ta dish ti djalë se jam edhe unë një nga ata njëqind pleqtë që kam firmosur e jam zotuar...

* * *

Dy javë më vonë pas këtij takimi të rastit midis xha Ramizit, xha Ganiut dhe shkrimtarit, rinia e fshatit u lexuan të dy pleqve në darkë në vatrën e kulturës gazetën, ku ishte botuar tërë biseda e tyre.

E dëgjonin të dy pleqtë dhe qeshnin nën buzë.

Kur mbaroi leximi, xha Ganiu hoqi përsëri qylafin e bardhë, ferkoi sheshin tullac të kokës, si të përzinte prej andej përsëri Mizat përdhese, dhe tha:

— Nuk ka gënjer, jo.

— Shyqyr, xha Gani, — qeshën të rinjtë, — shyqyr që nuk e ke sharë kryetarin, se...

— Për ato që kisha pér të sharë, e shava, unë, sa kusur nuk i lashë. Edhe ai i ka shkrojtur të tëra. Po pér ato që nuk i ka, unë nuk mund të shpifja.

Toni i zërit të Ganiut ishte i tillë si të tregon te se ai nuk kishte frikë të thoshte të vërtetën.

PSE U LARGUA XIXËLLONJA NGA SHTËPIA

Atë mëngjez Xixëllonja u ngrit më vonë se çdo ditë tjetër. Sytë i kishte të buhavitur, ftyrën të vrarë dhe i dridhej trupi. Tek po rrinte ulur mbi sëndukun e plaçkave, mendoi pér shokët e shoqet e brigadës që do të ishin duke prashitur pambukun e duke kënduar në atë ditë të bukur maji. Ju helmuza zemra pér fatkeqësinë e saj dhe kërceu në këmbë menjëherë, e inatosur me vetë-veten: «Unë e vendosa! Ç'pres?»

Hapi sëndukun, nxori që andej një bohçe të madhe, hodhi në të cip mbi cip, pa i palosur e me nxitim, si ta ndiqte njeri, ndërresat e saj, të fëmijëve, ca fustane dhe pastaj ngriti Yllkën nga gjumi, e rrëmbeu në krahë ashtu përgjumësh, urdhëroi edhe Petritin gjashtëvjeçar të ecte përrapa dhe u nis me hap të vendosur.

— Nuse, ku po shkon ashtu? — i thirri e vjehrra me një zë kanosës, kur e reja ishte në mes të oborrit.

— Në derë të babait, — iu përgjegj Xixëllonja pa kthyer kryet.

— Pse, moj nuse, kështu? . . . — u çirr e vjehrra, po ajo nuk e la t'i mbaronte fjalët.

— Ah, nënë, — iu përgjegj, — psenë e di vetë

ti, pyet edhe tët bir. Mjaft, më vajti thika në koskë!
Ditën e mirë.

Prapa krahëve të saj u mbyll dera e oborrit
dhe ndihej zëri i së vjehrrës, që nuk i interesonte
më ta dëgjonte në shante apo mallëkonte.

Kur vajti në derë të babait, e ëma nuk e ndjeu
fare, veç kur hyri në kuzhinë. Me ta parë ashtu të
prishur në fytyrë, nëna i thirri.

— Korbë! Ike?!

— Po, nënë.

— Po turp, moj bijë, turp! Duroje...

— Nuk bëra ndonjë turp. Durimi ka kufi,
nënë....

Nënës iu dhimb e bija. Shkoi i hodhi duart
në qafë. Mori me mend se diçka e padurueshme
do t'i kishte ndodhur natën e kaluar dhe e pyeti:

— Po pse, moj bijë, ç'të ngjau? — Pastaj vazh-
doi si me vete: — Ah, korba unë, ç'fat më pate,
moj bijë!

— Gruaja e do shokun e jetës. Por, ta kam
thënë gjithmonë, ai kurrë nuk ka qenë përmua
shok jete. Mbrëmë u mbush kupa, — i tregoi e bija.

— Nuk mund të duroj të verë njeri dorë mbi mua.
As babanë. Po arriti puna gjer atje, nuk ka nder
as gruaja për atë burrë, as burri për atë grua.
Gomari rrihet me dru. Prandaj...

Ngashërimi nuk e la të vazhdonte, ose nuk
deshi t'i shtynte fjalët më tej.

— Pse, moj korbë?!... — pyeti nëna përsëri
e lemeritur, pa i mbaruar fjalët, si ta kishte marrë
me mend ç'i kishte ndodhur. Dhe pastaj tha: — Po
ti u bëre edhe me fëmijë, moj fatzezë?!

— Nuk ka gjë, nënë. Mirë që i kam. Jam e zonja vetë t'i rris e t'i ushqej. Kam krahët e mi.

* * *

Një muaj pasi Xixëllonja kishte ikur nga shtëpia e burrit, e lajmëroi brigadieri të paraqitej në kryesinë e kooperativës.

Në mbrëmje, Xixëllonja shkoi në zyrat e kryesisë. Me të parë edhe Ramizin atje, një valë e nxehjtë gjaku i përshkoi tërë trupin, u skuq e u bë flakë, u turbullua për një çast, por pastaj e mblo-dhi. «Ca më mirë», tha me vete, «ca më nire kështu».

Në kryesi ishin mbledhur të gjithë anëtarët e organizatës bazë të partisë, të këshillit popullor dhe të kryesisë së kooperativës. Aty bënte pjesë edhe kryetarja e organizatës së gruas, Drita.

— Ulu, Xixëllonjë, — i tha ajo kur vuri re tronditjen e saj, — ulu!

Toni i zërit të Dritës ishte dashamirës dhe urdhëronjës në një kohë. Xixëllonja i hodhi sytë, e shikoi dhe iu duk sikur ajo i thoshte: «Pse tronditesh?»

Hajdari, sekretari i organizatës bazë të partisë, siç kishte pështetur bërrylin mbi tryezën pranë së cilës qe ulur, thithi cigaren dy - tri herë me radhë pa ja hequr sytë Xixëllonjës dhe mendoi: «Më duket sikur të gjithë ne e kemi marrë në qafë këtë vajzë! Të gjithë ne jemi fajtorë ndaj saj». Para shtatë vjetësh ai dhe Xixëllonja kishin qenë në një organizatë bazë rinie. Ai arriti nga kandidat, anëtar partie, dhe tanë kish dy vjet që ishte sekre-

tar i organizatës bazë. Kurse Xixëllonja rekordmenë në mbledhjen e pambukut për tre - katër vjet me radhë, ishte fejuar me Ramizin. Që atëherë ajo nuk bëri lart, por poshtë e më poshtë. Në fillim rralloi ardhjet në grupet artistike, gjersa në krye të vitit, si u martua, u shkëput fare. Mandej, nuk dukej as kur bëheshin mbledhje, konferenca, mbrëmje dëfrimi, çfaqje; ose dukej shumë rrallë. Edhe ditët e saj të punës vinte i merrte i shoqi në llogarinë e kooperativës.

Xixëllonja kishte vështrimin e njeriut të habitur që akuzohet për faj.

— Shoqja Xixëllonjë si vete me punë? — e pyeti Hajdari.

— Mirë.

— Pambuku në parcelat e brigadës tuaj edhe sivjet mban rekordin. Si duket, prapë do ta merrni flamurin.

Xixëllonja ngriti supet me hijeshi. Ai gjest u kujtoi të gjithëve Xixëllonjën kur ishte vajzë, aq të hijshme dhe aq të thjeshtë, të dashur, gjithë gaz, gjithë energji, të palodhur, të papërtuar për çdo punë bujqësore e për çdo aktivitet shoqëror. U kujtoi dy sytë e saj të butë si kadife, që tani nuk kishin mbetur veçse si një kujtim i bukur në mendjen e tyre. Ajo tani përmendej veçse për teikalimin e normës në punë. Dikur gazetat shkruanin vëzhdimisht për të, kurse tani kishte kohë që ishte harruar. Kur bashkëfshatarët e saj shkonin në qytet e takoheshim me të panjohur, gëzoheshin shumë, kur ata u thoshin plot dashamirësi: «Qenkeni nga fshati i Xixëllonjës! Si vete rekordmenja?».

— Shoqja Xixëllonjë, — e prishi heshtjen Haj-

dari, — dëshira jonë është që të të bashkojmë prapë me shokun Ramiz. Ju e dini vetë, po ne duam t'ju ndihmojmë, se mendojmë që gjithshka mund të zgjidhet. Veçanërisht neve na vjen keq për ty, që të kemi pasur. . . Shoku Ramiz ka kërkuar ndihmën tonë. Ai do të thotë të tijat, ti të tuat, dhe ne t'i vemë kapak kësaj pune. . . — Në fund Hajdari iu drejtua Ramizit: — Folë shoku Ramiz.

Pa lojtur nga vendi, duke rrötulluar kutinë e duhanit nëpër duar, me sytë ulur, Ramizi filloi:

— Ç'të them unë? Unë grua e kam pasur dhe grua e kam, prandaj ju jam drejtuar edhe juve. Ajo është ca kokëfortë, e rrëmbyer, edhe pleqtë nuk para. . .

Nuk e mbaroi fjalën. Ndoshëta desh të thosh «nuk para m'i dëgjon, ua kthen fjalën. . .» sikundër qenë hapur plot fjalë nga dera e tyre.

— Kaq? — pyeti një zë.

Ramizi ngriti vetëm supet, si të donte të thosh: «Ç'të them? Nuk kam tjetër».

— Po ti, shoqja Xixëllonjë? — iu drejtua asaj Drita, — si thua?

Xixëllonja u e bë bardhë në fytyrë si ajo gëlqerja në mur. Pastaj, pak nga pak mollëzat e faqeve iu skuqën. Herë i vinte duart mbi tryezë, herë i ulte për t'i fshehur që të mos e shihnin si i dridheshin.

— Po t'ju tregoj tërë jetën time me burrin, që nga dita e fejesës me të e gjer ditën që ika, — tha ajo me zë të dridhur, por plot siguri në vete, në ndershëmërini e pastërtinë e shpirtit të saj, — do t'ju mbaja tërë natën këtu. Por ju e dini cila kam qënë unë. Dhe unë e kam shpirtin plagë për atë që kam qenë e për atë që jam.

Uli sytë. Zemra zuri t'i rrihte me forcë. Mori frymë thellë dhe vazhdoi:

— Por unë, gjithmonë duke u trembur se mos bëj turp, se mos bëj sherr, se mos bëhem shkaktare e prishjes; duke u munduar ta bindja se nderin e ruaja për vete e jo për atë, dhe duke shpresuar se do të bindej një ditë, kam duruar sa s'durohej. Në fund...

Asaj iu drodh buza. Mezi e mbajti ngashërimin. Të gjithë sa ishin në dhomë mbetën me kryet ulur pa guxuar ta vështronin në sy. Tërë qenja e saj dukej sikur thosh: «A jini të bindur ju, se unë kam të drejtë?»

Ramizit i kishte rënë një të zi në fytyrë, dhe vështronte si të ishte i penduar që kishte kërkuar një mbledhje të tillë.

— Unë, — tha Xixëllonja duke shtrënguar shaminë e duarve, do t'ju tregoj vetëm një ditë ngajeta ime: Në mbrëmje vi e lodhur nga puna. Sapo vi, më thotë vjehrra: «Nuse, rrëmbe ata qypa dhe na mbush ujë! Ju e dini sa larg e kemi ne burimin. Me të prurë ujët, vjehrra thérret: «Ku je, mos të ardhtë këmba, se e piu viçi lopën!» Marr kusinë e shkoj mjel lopën. Pa mbaruar këtë punë, vrapoj te çupa që pëlqet së qari. Pastaj do të ulem në katua «të rrëmbej një krah dru». Do të shtyj urat të bëhet gjella. Do të shtroj e ngre sofrën. Burri rri në klub. Luan domino. Lexon gazetën ose dëgjon radion në vatrën e kulturës. Kur vjen në darkë, pyeti: «Akoma nuk është bërë darka?» dhe vrejtet në fytyrë. I bie me shkëlm ndonjë gjymi a tenxhereje, ç'të gjejë përpara, tërë xhind dhe shkon shtrihet në minder e pi duhan. Po të qajnë fëmijët,

xhindoset, «se nuk i duron dot» dhe thërret: «Merrri, apo t'ua bëj trutë spurth». Si mbyllët darka, nusja do të hedhë saçin, se do të piqen dy bukë pér të nesërmen. Sa të bëhet saçi do të laj enët. Çdo natë ka edhe punë të tjera. Një herë do të laj rrobat e të gjithëve. Një herë tjetër do të laj skutinat e fëmijëve, se jam me fëmijë të vegjël. Duhen andruar rrobat e lara. Duhen hedhur çarçafët e organëve. Çdo natë **nuk bie** të fle kurrë përpara orës dymbëdhjetë a më një pas mesnate. Në mëngejz duhet të ngrihem herët, se do të millet lopa, do bëhet gati mëngjezi... Me pesë orë gjumë në natë shkoj realizoj edhe normën, siç e dini, njëqind e njëzet përqind. Qëllon që natën, pasi kam rënë të fle, më qan çupa. Nga lodhja nuk ndjej. «Ngrehu, fjeç të madhin!» ulërin im shoq dhe nuk i bën dora ta tundë pesë minuta, se ai i ka bërë pesë orë gjumë gjer atëhere, meqë bie që më tetë. Natën e fundit, pér këtë shkak deshi edhe të më godiste. Nuk e lashë. Çnder do të mbetej pér mua atëhere!

Sy kureshtarë u kthyen nga Ramizi, sikur të ishte një fytyrë e panjohur pér ta. Ai, kokulur, thithë cigaren e nuk ndihej.

— Veset e këtij, — tha Xixëllonja në fund, duke fshirë ballin me shami, — nuk ka ligj që t'i dënojë. Pér këto gjëra ligji hesht. Por, kur ai desh të bënte atë që edhe ligji e dënon, unë e dënova vetë më parë.

Ajo u ul duke i vështruar të gjithë shokët sy më sy, edhe Ramizin, të cilët i pa vetëm kasqetën, që dukej si e vendosur mbi një grykë thesi të leشتë që ulej e ngrihej.

Sytë e të gjithëve i thoshin qartë, duke vësh-truar sa nga ajo, nga Ramizi:

— Ai e meriton dënimin që i ke dhënë.

Dhe pas një heshtjeje të shkurtër, kumboi zëri i kryetarit të kooperativës:

— Ke bërë shumë mirë, shoqja Xixëllonjë!

Zëra të tjerë aprovues u dëgjuan në sallë.

Ramizi atëhere ngriti kryet si i zgjuar nga një ëndërr e ligë dhe po shikonte sikur ata zëra të kishin qenë një grusht i fuqishëm që e kishte goditur në kraharor, duke i thirrur në të njëjtën kohë: «Ej, mblidhe mendjen, se nuk e ke mirë!» Ai nuk deshi të fliste asnjë fjalë për t'u mbrojtur, por as shokëve nuk kishte kurajo t'u kërkonte më që të bindnin Xixëllonjën të kthehej në shtëpi. U ngrit ngadalë i heshtur, duke mbështetur të dy duart buzë tryezës, krejt i pafuqishëm. Fytyra e tregonte sikur mbi shpatulla e në ndërgjegje i rëndonte pendesa e thellë me tërë peshën e saj, dhe, duke u uruar shokëve «natën e mirë», doli jashtë.

— Do të gdhendet, — tha kryetari i kooperativës për të, me një ton plot shpresë, kur Hajdari, sekretari i organizatës bazë i shkoi pas.

Dhe vështroi nga Xixëllonja. Kurse ajo nuk foli, por dhe me heshtjen e vet dukej sikur thoshte:

— Po të vërë mend...

L U M T E R I . . .

Në vizitën e fundit, pasi e pa radiografinë mirë e gjatë dhe e la mbi trapezë, doktori i tha qetë e me buzën në gaz:

— Ti djalë je shëruar fare. Këmba të është zënë shumë mirë. Nesër do të dalësh.

Clirimt i shkëlqeu fytyra nga gëzimi. Po të mos ishte turp do t'i hidhej doktorit në qafë ta përqafonte fort e ta puthte.

— Të falem nderit, shoku doktor. Ju falem nderit të gjithëve.

Nga dridhja e zërit të tij, mjeku u mallëngjye dhe ndjeu, si shumë herë të tjera, kënaqësinë e thellë të frutit të punës së vet. Mustaqet e holla e të zeza i qeshën.

Ishte tip i rëndë në dukje, nuk fliste shumë, sikur nuk ndjente as gëzime as hidhërimë, por prapëseprapë kishte një zemër të ndishme. Të ritë e këtij djali, shëndeti i bukur, sytë e gjallë e të zgjuar i kujtuan rininë e tij, dhe në çastin që i ktheu krahët për të vizituar të sëmurin tjetër, si të qe penduar, u kthye, i ra faqes dhe i tha:

— Hap sytë herë tjetër.

— Doktor...

— E di, e di, po prapë hap sytë... Më ka fjalosur kryetari i kooperativës tuaj si të ka ndodhur.

Në qershor, skuadra ku bënte pjesë Çlirimi, priste trarët në pyll, sipër, rrëzë malit, për shtëpinë e kulturës. E kishin marrë atë punë me gjëzim, sepse mezi e prisnin të inaugurohej. Atje do të kishin radio, do bënин mbrëmje vallzimi. . . Mirëpo, kur ishin duke prerë traun e fundit, bredhi i gjatë desh e kishte shtypur një nga shokët. Çlirimi e kishte shpëtuar, por bredhi i pat zënë këmbën e djathhtë atij vetë e ja kishte thyer keq.

Ras tre muajsh që ndeji në spital, ja ku e dëgjoi më në fund atë që priste. «Nesër do të dalësh». Po edhe sa orë duhet që të vijë e nesërmja? Po po! këto katërmëdhjetë-pesëmbëdhjetë orë janë sa tre muajt. «Nesër do të dalësh. Nesër do dalësh», i dukej sikur jehonte i tërë pavjoni, që kishte marrë një pamje tjetër për sytë e tij. Hodhi vështrimin nga dritarja që kishte te koka e krevatit. Në lulishtë përjashta kishin mbetur vetëm dy të sëmurë ulur në një fron e diç bisedonin e qeshnin. Zogjtë nëpër pemë cicërinin. Qielli i vjeshtës ishte i larë, i pastër në një blu të ëmbël joshëse dhe drita e bardhë e diellit binte e gjuar në gji të luleve të kopshtit.

Me të ikur doktori, ai u ngrit, rrëmbeu patericat dhe sikur fluturonte, këc këtu e këc atje, shkoi krevat më krevat e u tha shokëve:

— Nesër do të dal.

Doli edhe në korridor, nëpër pavione të tjera ku pat zënë miq. I vlonë gjëzimi përbrenda dhe donte që ta mësonin të gjithë se atij i kishte thënë mjeku: «Nesër do të dalësh». Dhe të gjithë, pasi e

uronin me shpirt, thoshin pa e fshehur keqardhjen:

— Na vjen edhe keq, or të shkretën, të kishim për çdo gjë. Ti na ishe bërë nënë e baba.

Çlirimi ishte njeriu që dukej sikur kishte lindur për të mos pasur qetësi për vete. Me t'u ngritur me paterica, i mbante veshët përpjetë; kush thërriste për ujë, për të lajmëruar infermijeren apo sanitaren, për t'i marrë cigare apo fruta në dyqanin e spitalit... dhe ai çohej menjëherë t'i shërbente.

Drekë hëngri fare, fare pak, se iu pre oreksi nga gëzimi. Vajti u ul në shtrat dhe me mend shkoi në fshat. Iu bë eëma kur e qërtonte gjithmonë me zë të ëmbël: «Or bir, po shtrohu, rri një sahat i qetë. Çlodhu. Unë sikur ta kam përpjekur kokën jashtë kur ke lindur. Duke puna me udhë duhet!» «Ç'ke ti nënë? Të mungon gjë?» «Jo, or bir, jo. Të paça sa malet, po...» «Rri ti nënë, rri rehat; ç'të të duhet, më thuaj». Duke përsëritur këtë dialog, vuri buzën në gaz i mallëngjyer. U mundua të merrte me mend shtëpinë e kulturës, tanimë të përfunduar e të paisur me të gjitha: radio, libra, gazeta... sikunder i kishin thënë shokët kur kishin ardhur e e kishin parë. Përfytyroi të rintjtë e fshatit, duke dëfryer atje. U dha vetë në derë i mbajtur mbi patericë. Të gjithë çohen drejt tij, e rrëmbejnë në krahë, e përqafojnë fort, i japin dorën. Ja edhe Shpëtimja vjen pa u ngutur, e fundit fare, vjen i jep dorën e ja shtërngon me fshehuri pa e vështruar në sy. «Po kjo! — çuditet me vete, — çka kjo që e tregon vreten kaq hapët që ne të dy!... Asnjëri nuk di gjë. Unë as nënës nuk i kam thënë akoma. Kurse kjo bën kështu që ta kuptojnë të gjithë!» I bie zemë-

rimi shpejt e shpjet. «S'ka gjë, s'ka gjë,» i thotë Shpëtimes, si ta ketë aty përbri në krevat ku është ulur vetë me këmbët varur e i përgëzon shpatullat, «ne nuk do ta mbajmë më të fshehtë. Ti më shkruaje sikur edhe sakat fare të mbetesh e të zesh këndin, unë nuk të lë, nuk ndahem prej teje. Po ja, shikomë. Koska m'u zu siç e kisha. Do të eci edhe pak me paterica e pastaj «urra!» në arat e malit bashkët...»

—Po fjalosesh me vete më duket, Çlirim! — i tërheq vëmendjen atë qast i sëmuri pranë dhe i buzëqesh. Në buzëqeshjen e tij fshihen plot gjëra. Çlirimi ja ka treguar punën e tij me Shpëtimen.

— Jo, or jo...

— Léri ato, se e di vetë unë. Pa më shiko mua këtu.

Shoku zë kapakun e poshtëm të syrit me gish-tin tregonjës dhe e shqyen poshtë.

I qeshin të dy shoshoqit përzemërsisht.

— Ja, edhe ti, së shpejti do të dalësh, — i tha Çlirimi.

— Do të dal, do të dal, po...

Shoku nuk e mbaron fjalën, psherëtin. Atij ja ka prerë mjeku? Duhej të rrijë edhe një muaj e gjysmë akoma. Nuk i durohet. Çlirimi kujton fjalët e tij: «Ti thua: të vete edhe një herë të mbërthej punën, pa një vit jetë fal. Po edhe unë, të vete edhe një herë t'i bie tornos sime përsipër, pa dy vjet fal, jo një. Sa i mirë është spitali, aq edhe i mërkitshëm». Sytë e tij duket sikur i thonë Çlirimit:

— Lum ti që u shërove dhe po del! Shpëtove!

Vjen darka. Të gjithë flenë. Mendja e zemra e Çlirimit shëtisin, si zog nate i arratisur, shtëpi

më shtëpi, oborr më oborr, rrugë më rrugë, nëpër tërë fshatin. Vjeshtë. Ja kopshti i Trëndelinës. E vjetmja është si kopshtare kjo. Po po! ç'kunguj pjetës që ka rritur! pesëmbëdhjetë kile një! Pa shiko ç'lakra armeje ka edhe sivjet! Pale domatet, pyll i ka, pyll! Në fund qëndron te muri i lëmit të të jatit të Shpëtimes. Ftonjtë e tyre rreth e qark shtëpisë janë pjekur. Dora e vjeshtës i ka zverdhur fare dhe duken nëpër terr të natës si qindra fenerë të verdhë të varur. Ja ku po vjen edhe Shpëtimja duke hedhur hapat ngadalë e duke hapur me të dy duart degët e ftonjve. Nuk ja shëmbëllen dot fytyrën se është larg. Ajo afrohet. Ka kafshuar gishtin tregonjës si ndonjë bebe, nënqesh, dhe i bën shënje të mos rrëmbehet. Me duart që i dridhen e shputat e nxehtha pushton një trup të ngrohtë që dridhet i téri dhe mbyll buzët e saj me të tijat. Humbet ashtu në dremitje. Dikush kollet nga fundi i pavionit. Nga kjo hap sytë i trëmbur e kërkon diçka me duar. E kupton se ka qenë në èndërr. Fillon e endet arë më arë. Përfytyron misrat e kooperativës ashtu det siç i kanë thënë. Arat e mbjella lashtë, andej nga buzët e lumit, janë korruar e kapulet duken radhë - radhë. Njëzet e pesë kile misër të thatë e të shkoqur ka një kapule. Ai zë numëron kapulet. Atë sektor e ka brigada ku punon ai. Ka mbjellë vetë në ato ara, ka prashitur vetë. Dy javë më parë, brigadier i tij i ka thënë: «Vetëm ara e Sulçes ka dyqind kapule misër». Sheh veten të ulur pranë atyre kapuleve, me patricat lënë mënjanë, duke këputur misër. «Po», thotë, «misër mund të këput fare lehtë që të nesërmend apo të vete». Dhe prapë i bëhet zëri i së ëmës tek e qor-

ton: «Po rri, or bir. Kryetari i kooperativës të thottë: — rri, ose bëj ndonjë punë roje pér ca kohë. — Rri, shiko vetën, se desh e le kokën një herë. Ti sikur ke lindur pér të tjerët, or bir». Qesh. E përgëzon të emën: «Nënë! Të gjitha të miat janë, kur janë tonat. Ti nuk e kuption akoma? Arat tonat janë. Misri yni është. Duhani yni. Rushi yni. Kujt t'i fshihem unë? Kujt t'i bëj bisht? punës sime?!» Në shpirt i vlojnë ndjenja dashurie. Mendon si të bëjë mirë. Endërron me buzë në gaz si ato foshnjet që qeshin në gjumë. Pas fatkeqësisë që i ndodhi, ai ndjen një dashuri më të thellë e më të zjarrtë pér fshatin. Nuk mbeti njeri pa i ardhur në spital. Të gjithëve u sjell ndërmend fytyrat e dëshpëruara te koka e shtratit të tij e i falënderon me zemër. «Të kemi lulen e fshatit, or bir. Ti, Qemali, Nuredini, Fatbardhi, Shpëtimja, Manushaqja... jeni nderi i kooperativës...», dëgjon zërin e xha Qamilit mbi kokën e krevatit dhe sheh si fshin lotët. «Njeriu i mirë do vetëveten, or bir. Kur mora vesh pér ty, sikur më thanë pér Kujtimin tim, ashtu më erdhi keq». I shkon përsëri mendja në fshat. Vjeshta, e ngarkuar me të gjitha ato që rriti vera, e që ajo i poqi, duket sikur ka zbërthyer gjitë e begatshme dhe pret ta vjelin. Toka pret të pushojë. Pemëve t'u çlodhen krahët.

Dhe ja prapë i bëhet sikur është te muri i lëmit të babait të Shpëtimes...

E kapit gjumi. Endërrit...

Kur arrin në fshat jeton të gjitha ato që pati marrë me mend në spital, por tani të gjalla, të vërteta. Nuk i sheh me sytë e mendjes, por me të ballit. Shokët s'gjejnë vend ku ta vënë. Ata nuk pu-

shojnë së përqafuari. Shpëtimja e ngroh me vështrimin e saj të ëmbël. Zemra i këcen nga emocionet. Kupton sa i fortë ka qenë që ka duruar aq kohë larg punës e si nuk mund të jetojë dot pa atë, pa fshatin, pa aromën e veçantë që ka dheu në mëngjez, në drekë kur dielli djeg e gjethet e misirit zënë e kërcasin tek rrinë, në mbrëmje kur vesa krijon aroma të reja e çdo gjë zbutet. Vija e ujit të shkumbëzuar që kalon përmes fshatit, e çlodh. Shtëpia e kulturës është bërë njëqind herë më e bukur nga q'e pati marrë me mend. Ka dëshirë të hapë krahët, të pushtojë gjithshka të natyrës për rrëth, me atë bukuri aq të njojur, por edhe aqë të çuditshme, të mrekullueshme, dhe do që të thérresë sa ka në kokë: «Ku paskam qenë?!»

Nuk mundi të duronte. Ndejti vetëm një ditë në shtëpi, u çlodh, dhe të nesërmen i hipi mushkës që me kaponjtë e parë, shkoi me brigadën, ku bënte pjesë, në arat e buzës së lumiit për të këputur misër. Gjer te kapulet shkoi me patericat. Atje i la ato mënjanë, u ul, ktheu gjysmën e kapules e rrëzoi përdhe dhe filloi. Vesa e kishte bërë kashtën e misrit mëndafsh. «Asnjë bëzhdile zahire nuk humbet kështu,» u kënaq me vetëveten. Gryka e lumiit ndillte një erë të lehtë.

Kapi me duart e fuqishme (por të bardha qumësht tani e pa kallo) një kalli, e këputi, e hodhi tej. Edhe një tjetër, edhe një tjetër... Ato duar donin të tretnin gurin, nuk ishin për të këputur misër. Punë pleqsh! Ngriti sytë, pa lart qiellin mavi e yjet që kishin zënë të ngriheshin më lart, të digjeshin një nga një, të treteshin e të rralloheshin. Zogjtë këngëtarë çaheshin së kënduar, niëpër shel-

gjet që shushurinin bashkë me ujin e lumit. Radhë, pas tij, ishin ulur gjithë shokët e tjerë dhe ndihej zhurma e njojur, e pandërprerë e kashtës së misrit, nga shpejtësia e duarve që i merrnin. E treta në radhë **ishte Shpëtimja**, që këpuste misër me fytyrë të kthyer nga ai. Gjoksin e ndjeu shumë të ngushtë për të mbajtur brenda tërë atë gëzim që ndjente, dhe tha me vete:

— Ju dua shokë, të dua fshati im, të dua punë... Të dua o jetë!

— C'lumtëri!

DUKE UDHËTUAR ME TRENI

Në stacionin e trenit, pesë minuta para se të binte sirena e nisjes, takova Bashkimin, shokun tim të klasës, sot e njëzet e pesë vjet të shkuara. U gëzova, sepse siq thotë një fjalë e urtë popullore, «kur je vetë i dytë të ngroh edhe fryma e shokut».

Në një nga stacionet, treni qëndroi. Para kabinës sonë kaloi një djalë rrëth të tridhjetave me veshje fshatare. Ishte duke zbritur. Në krye vështroi nga ne pa ndonjë qëllim. Pastaj, ja nguli sytë Bashkimit për një çast dhe si u sigurua që e njohu, hapi derën e kabinës. Bashkimi, me ta parë, kërceu në këmbë e thirri: «Nazmiu!» Dhe i hodhën duart në qafë sho-shoqit, duke u puthur buzë për buzë.

Si u ndanë dhe pasagjeri zbriti shpejt e shpejt, sepse treni atje nuk qëndronte veçse pesë minuta, Bashkimi më tha:

— E kam pasur ushtar, kur isha komandant poste në kufi.

— M'u duk djalë i dashur dhe i ndershëm, — u shpreha unë! — Kuqeji kur fliste. Njihet njeriu që në vështrim të parë.

— Edhe trim e patriot djalë, u hodh Bashkimi.

— Kam një kujtim nga ai që nuk do të më harrohet gjithë jetën.

— Na e trego, — iu luta me interes të veçantë.

Dhe Bashkimi më tregoi, gjatë rrugës që na mbeti për të bërë, këtë histori:

«Siç e di, — më tha, — para se të vija në repartin e tankeve, unë kam shërbyer në repartet e rojeve të kufirit. Një natë, dhjetë vjet të shkuara ka kjo, aty nga ora nëntë më vien një nga kufitarët, i prishur në fytyrë, dhe më thotë:

«Shoku toger...» Unë isha duke shkrojtur një letër për në shtëpi dhe qeshë pushtuar nga mili për prindët e për tërë njerëzit e mi. Edhe për gurët e fshatit më kishte marrë malli. «Hë mo,» i them, «ç'ke?!», tek e pashë ashtu të zymtë. «Nazmiut i ka vdekur i ati», më tha ai me zë të ulët. «Nazmiut!» — thirra ngadalë. Por nuk po u besoja veshëve. «Afroju», e urdhërova, «Afroju! Leri ato». E kisha fjalën për qëndrimin gatit që mbante. Dhe e pyeta: «Si është puna?» «Ushtar Nazmiut i ka vdekur i ati», përsëriti kufitari. «Kush të tha tani në mes të natës?» «Ka ardhur një i kushëririn». «Ku është?» «Përjashta». «Thirre të vijë brënda, por ngadalë mos ndjejë Nazmiu». Nazmiu po flinte se në orën dymbëdhjet do ta merrte ai rojën. Ishte një djal i qetë, i urtë, pa shumë fjalë, që nuk ta mbushtë shumë syrin. Ai tre muaj kishte që shërbente në armën e rojeve të kufirit dhe nuk pat qëlluar ndonjë rast që ta provoja. Po sidoqoftë ishte i disiplinuar, detyrat i kryente me përpikmëri e pa bujë, dhe e doja njëllojë si gjithë kufitarët e mi të vjetër. Të atin ja njihja mirë dhe i patë shkuar në shtëpi disa herë. Qe burrë i nder-

shëm, patriot, burrë me hije dhe i nderuar nga të gjithë. Nuk ishte më shumë se pesëdhjetë vjeç. Prandaj, kur dëgjova për vdekjen e tij, më dhembi si për një të afërmin tim. Erdhi i kushërir i Nazmiut brenda. E pyeta si kishte ndodhur. Me sa kup-tova nga fjalët e tij, ai do të kishte vdekur nga ndonjë pushim zemre medoemos. E bisedova me të kushërin që t'i thoshim kufitarit se i ati ishte i sëmurë rëndë dhe e kërkonte. Dhe kështu vepruam. Për ta zëvëndësuar në roje dolën plot kufitarë të tjerë vullnetarë dhe i thashë kur e përcolla: «Nesër mund të vij edhe unë ta shoh pak babanë, Nazmi. Ti, me këtë rast, rri atje dhjetë ditë me leje».

Dikush na hyri në kabinë, na kërkoi një shkrepse të ndiste cingaren dhe mandej doli.

Po atë natë, — vazhdoi Bashkimi, — sapo feksi, — më vjen kufitari që zëvendësoi në roje Nazminë dhe më njoftoi se te një vend që quhej «Përroi i Moçaleve», ku nuk ta priste mendja fare, kishin kaluar diversantë.

— Si?! — e pyes i habitur. Dhe me vete mendoj se nuk ishte e mundur: natë, dimër, ftohtë, dëborë, gjurmët njihen e armiku mund të diklohet në të aguar...

— Kanë kaluar, shoku tøger, — më thotë kufitari me ton bindës, duke gulçuar e i nxituar, si të më thosh me atë: «mos dysho, po ngreu! ..» — Kanë kaluar! — përsëriti ai i paduruar.

— Nga e di ti? I ndjeve? I pe me sy? Ke parë gjurmata?

— Dhe u ngrita, jo se isha plotësisht i bindur, por për të mos bërë figurë të keqë ndaj kufitarit, që kishte ardhur aq i alarmuar, dhe që më qën-

dronte përpara gatitu me një shprehje të fytyrës si prej fajtori, që nuk i kishte diktuar.

— Në qoftë se do të jetë e vërtetë që do të kenë kaluar në atë vend ku thotë ky», mendova me vete, «ata që kanë kaluar janë njerëz me të vërtetë të zotë dhe do të kenë pasur me vete njeri që i njeh me pëllëmbë këto vende».

Duke dalë përjashta, e pyeta kufitarin:

— Sa gjurma janë?

— Shumë.

— Po sa për shembell?

— Pesë, gjashtë, shtatë mund të kenë qenë.

— Çfarë këpucësh kanë?

— Janë gjurma derrash.

E shikova drejt syve. «Eshtë në vete ky, apo mos ka lojtur?» Mirëpo nga përvoja dija mirë se armiku nuk lë mjet e marifet pa përdorur për t'ja arritur qëllimit të vet.

— E po atëhere mund të kenë qenë me të vërtetë derra, — i hoqa vërejtjen kufitarit gjysmë me dyshim, gjysmë me bindje dhe po nxitonim të dy drejt «Përroit të Moçaleve». Kufitarët e tjerë i porosita si do të vepronin me të parë shënjet që do t'u jepja që andej ku po shkoja.

Jo, — m'u përgjegj i bindur kufitari, — ju vetë na kini mësuar... Ato janë vërtet gjurma derrash, por derrat nuk ecin ashtu. Ata...

Që të mos e zgjas, — tha Bashkimi duke thithur cigaren i entuziazmuar që po thërriste në kujtesën e vetë atë kohë të jetës së vet prej kufitari, — kur arrita në vend, pashë se me të vërtetë diversantët kishin kaluar kufirin gjatë natës, duke mbajtur thundra derash në këmbë e në duar, dhe u vumë menjëherë në ndjekje të tyre.

Diversantët pasi kishin 'kaluar zonën me dëborë e si kishin rënë në tokë të zezë, i kishin lënë thundrat e derrave dhe me t'i zënë dita, sipas planit të tyre të paracaktuar, ishin futur në një shpellë. I rrrethuam aty nga ora dhjetë e ditës dhe u bëmë thirrje të dorzoheshin. Mirépo nuk deshën. Domosdo plasi pushka. Ne bamp ata bamp. Vendin ata e kishin shumë të sigurtë. Po të prisnim gjersa të errej, me siguri që do të sulmonim dhe ne do të vrisnim disa, po ndonjëri edhe mund të na shpëtonte. Ishin shtatë veta. E dinim që shpella kish-te edhe një dalje tjetër nga sipër. Një orë pasi plasi pushka, na erdhën me dhjetëra fshatarë në ndihmë. Po bëhej pushkë si në një front të vërtetë. Diversantët ishin të vendosur të delnin nga rrethimi; po edhe ne ishim të vendosur që nuk do t'i linim sikur ta bënин dhëmbin sa të derrit.

Donte edhe tri orë të errej. I lashë forcat e këtejshme nga hyrja kryesore ku qëndroja edhe vetë dhe dola nga ata që luftonin më të sipërm të shpellës, nga dalja tjetër. Në atë krah luftonin tre diversantë. Më erdhi një mendim që nga ai krah t'u hidheshim që sipër me sulm, t'i detyronim ata tre të hynin brënda dhe t'u kërcenim bombat nga jart. Vendi i armikut nga sipër ishte i zbuluar e jo me mbrojtje të fortë. Po, për t'iu afruar, edhe për ne, nuk ishte aq lehtë. Ai copë shesh mbi shpellën ishte i rrezikshkëm edhe për ne, edhe për armikun. Sidoqoftë, mendimin që më lindi dhashë urdhër dhe e zbatova. Nga një gur ku kisha zënë vend, shoh katër kufitarë që hiqen zvarrë drejt daljes së sipërme të shpellës. Hiqen zvarrë dhe qëndrojnë. Shokë të tjerë, kufitarë e fshatarë, iu shtien diversantëve.

Ata nuk tunden nga vendi. Njeri nga të katër ata që hiqeshin barkas drejt armiqve me ngjau si Nazmiu, po nuk e besova. Të gjithë kufitarët një veshje kanë, një gjatësi, gati të barabartë janë shumica, prandaj nuk kishte pse të dyshoja. Pas një çasti, pikërisht atij që më shëmbellëu me Nazminë, e vura re që iu mbulua fytyra me gjak, por ai nuk po ndalej. Një prej të tre diversantëve nuk po shtinte më. «Hë», u gëzova me vete, «u palos një!» Mirpo, po më dhimbej për kufitarin e përgjakur. «Prite kur t'i ftohet plaga dhe të mbetet». Zemra më rrihte me forcë. Ai vazhdonte të zvarritet! «Do ta ketë pshikur plumbi», mendova, «ose do ta ketë goditur ndonjë copë gur.» Dhe me të vërtetë një gur i kishte çarë lëkurën e ballit, por thellë vec. Me t'u afruar në atë largësi sa i hante armiqtë bomba, të katër kufitarët dhe tre fshatarët që u kishin shkuar pas, i vërtiten bombat njëheresh dhe u çuan më këmbë. Edhe dy diversantët të tjerë u vranë.

Kështu, dalja e sipërme e armikut u mbyll. Dëgjova kufitarët që po thërrisin:

— Dorëzohuni, ose për ndryshe jeni të vrarë!

Dorëzohuni!

U çova dhe shkova shpejt atje. «Hapni sytë, mos u kalojnë!» porosita forcat që luftonin nën shpellë dhe diversantëve u thirra: «Jam komandanti i postës së kufirit. Po u jap tri minuta kohë. Ose dorëzohuni, ose do t'u hedhim bombat nga sipër». Një dorë më kapi nga kapota dhe më lutti: «Ruhu, shoku komandant. Mos u thërrisni ju. U thërresim ne». Dhe bombën e mbante mbi grykën e shpellës. Ktheva kryet dhe pasqë një fytyrë të mbuluar me gjak. Nuk i thashë asgjë atij, por urdhërova me

ton kërcënonjës një kufitar, duke i treguar ftyrën e përgjakur.

— Merr shokun dhe kujdesohu për të!

— Nuk do, shoku komandant. Iu lutëm që sapo u godit.

— Ju urdhëroj! — iu kërcënova të dyve.

Dhe ata u hoqën drejt pyllit.

Në kohën që bisedoja me kufitarët, pushkët në anëri e poshtme kishin pushuar për një çast. Pastaj u këmbyen përsëri. Pas një copë here dëgjova dy zëra të lemerisur që thërrisin nga gryka e shpellës:

— Jemi dorzuar. Mos na hidhni bomba!

Dy nga të katër diversantët që ishin brënda në shpellë sulmuani të çanin rrethimin dhe njëri u vra, tjetri u zu i plagosur. Dy të tjerët u dorëzuan vetë.

Kështu u shfaros banda.

Kur dolëm nga pylli dhe u mblodhëm te një kodër, shoh se kufitari i plagosur në kokë, që nuk e kisha njobur nga që i qe larë ftyra në gjak, kishte qënë Nazmiu.

— Nazmi! — i thirra, — po ti?! Ç'kërkove ti?!

Mori qëndrim gatitu, ashtu me kryet lidhur siç ishte, shtërngoi tytën e pushkës me dorë, vura re që iu zbardhën për një çast gishtat e dorës me të cilën shtërngonte pushkën, dhe m'u përgjegj:

— Në malet tonë, shoku komandant, kur është puna për mbrojtjen e Atdheut e të popullit, të vdekurin e qajnë plakat. Burrat dhe gratë që janë për pushkë e kanë vendin këtu. Edhe im atë, po të kishë gojë e të fliste për një çast si i vdekur, do të më thoshte: «bir, merr pushkën shko, dhe të më nderosh më shumë të vdekur se të gjallë».

Mbi gjurmët e dhimbjes që kishte lënë vdekja e të jatit në fytyrën e ushtarit, shkëlqente njëkohësisht edhe shpirti i tij patriotik i përflakur.

Nuk m'u durua. Iu derdha, e putha. E putha pa ndjerë të çmallur».

Tregimi i Bashkimit këtu mbaroi. Në këtë kohë, njerëz me valixhe ndër duar po kalonin në-për korridorin e vagonit. Kishim arritur në vendin ku do të zbrisnim. Bashkimit i ndritnin sytë, por edhe unë nuk isha më pak i emocionuar. Ra sirena.

Zbritëm, dhe fytyra e ish - kufitarit, që e njoha edhe si fytyrë para një ore, më rrinte përparrë syve krejt e ndryshuar, si një fytyrë shumë e dashur që nuk do të më harrohet kurrë.

DITËN E FUNDIT NË MËSIM

Qemal Guri dëftesën e aftësisë për mësues e kishte marrë në qershori të vitit 1938 në Normalen e Elbasanit. Në shtator të atij viti u emërua mësues në shkollën fillore «Naim Frashëri» të qytetit të vet. Atë mot që mbaroi Normalen mbushte njëzet e një vjeçët dhe e cte në të njëzet e dytë. Me trup vinte si në bojë të mesme, dhe i hollë. Kishte një fytyrë tërheqëse bojë gruri. Flokë të zez e të shtruar. Vetulla të zeza, dhe që në njojhen e parë të bëhej i dashur. Fliste shtruar, ishte i arësyeshëm, nuk mburrej kurrë dhe në bisedim dukej i pjekur si nonjë burrë i vojtur. Ndoshta e kishte bërë të tillë vetëjeta që kishte kaluar. Si biri i një farkëtari, çirak nëpër botë qysh se kishte zënë të punonte, ai nuk pati mbajtur kurrë një palë rroba të reja. Shkollën e kishte mbaruar me nota të shkëlqyera, me gjithë jetesën e vështirë që bënte dhe megjithëse s'kishte as të holla të blinte të gjitha librat që i nevojiteshin.

Drejtori i shkollës i dha klasën e tretë. Nxënësit e kësaj klase ai i shpuri gjer në të pestën, por nuk arriti t'u jepte dëftesën e lirimt, — kështu quhej atëhere dëftesa e nxënësve që mbaronin fillore, — sepse më 11 nëntor të vitit 1941 u hodh në ilegalitet dhe shkoi në mal partizan.

Kur hyri në klasë, ditën e fundit që bëri mësim, Qemal Guri dukej që atje tej se diç i vlonë në zemër e sikur donte të fluturonte me krahë. Nxënësit e tij kishin afro dy vjet, qysh se kishte push-tuar fashizmi italian Shqipërinë e këtej, që nuk e kishin parë ndonjëherë aq të gjëzuar. Pas pushtimit të Shqipërisë, Qemali pati mbetur për nxënësit e vet, si gjithmonë, i dashur, i afruar si një vëlla i madh e i vërtetë që kishte zënë vendin e prindit, porse në fytyrë dukej mirë se ishte gjithnjë i munduar e diç e mundonte përbrenda.

Kjo dhembje e vazhdueshme në shpirt, iu kujtonte nxënësve atë ditë mësimi kur Qemali kishte hyrë në klasë i vrenjtur në fytyrë e me një pikëllim të thellë iu kishte thënë: «Fëmijë të dashur, populli ynë u tradhëtua, Atdheu ynë u pushtua, por ne shqiptarët kurrë nuk iu jemi nënshtuar armiqve dhe kurrë nuk do t'i nënshtrohem as fashistëve italianë. Prandaj, të qëndrojmë të papërkulur! — dhe duke shtrënguar të dyja grushtet mbi tavolinë, kishte vazhduar: «Ne do ta çlrojmë Atdheun tonë si burrat dhe kurrë nuk do ta qajmë si frikacakë! . . .».

Fëmijët, që kishin lagur me lot rrugët e qytetit gjatë ditëve të demostratave dhe që ishin gati, që me ngacmimin më të vogël, t'ja krisnin të qarit edhe në klasë, i kishte pushtuar një ndjenjë turpi dhe e kishin mbledhur menjëherë veten. Toni me të cilin iu kishte fëiur mësuesi, ku ndihej vendosmëri e besim i patundur në ato që thoshte, i kishte shkundur. Një perde e zezë sikur iu ishte hequr nga sytë në atë çast dhe me një besim të madh në zemrat e tyre të njoma, se shpejt armiqtë do të

shporreshin nga Atdheu, kishin filluar mësimin e arithmetikës: «Një çetë shqiptare, në sulmin e parë që bëri kundra fashistëve italianë, vrau 50 armiq, zuri 50 pushkë, 3000 fishekë; kurse në sulmin e dytë, dy çeta së bashku, vranë pesë herë më shumë armiq...» Mësuesi diktonte duke vështruar tej dritareve si të jetonte betejat, dhe nxënësit numëronin armiq të e vrarë me urrejtje të eger për ta e me gjëzim të papërmabjatur për fitoret e shqiptarëve, si në të vërtetë.

Në orën e parë të ditës së fundit që bënë mësim me Qemal Gurin, klasa e pestë kishte gramatikë. Do të mësonin fjalinë dhe pjesët e saj kryesore. Qemali përshëndeti nxënësit, shkoi drejt trapezës së vet dhe pasi la çantën dhe regjistrin, u afrua përpara bankave të para. Duke vështruar nxënësit një nga një në sy, sikur t'i shihte për herë të parë, po fërkonte kokën, me të dyja duart. Gishtat e tij fshiheshin nëpër flokët që i rrinin gjithmonë të ndarë në mes.

Nxënësit po habiteshin me këtë gjëzim që shihnin në sytë e mësuesit të tyre. Ç'do të kishte ndodhur vallë? Por Ali Dragoti, Drita Lena, Petrit Çala, Gjin Rapi dhe Gramos Kurti, të pesë këta nxënës, e dinin arësyen e vërtetë dhe disa të tjerë të zgjuar e merrnin me mend. Me Ali Dragotin dhe katër nxënësit e tjerë, bashkë edhe me dy arsimtarë të shkollës «Naim Frashëri», Qemal Guri kishte bërë kaqë e kaqë aksione gjer atëhere. Ata, një natë, kishin prishur fjalët «Dux» e «Rex» që kishin shkrojtur fashistët me gurë në faqen e një kodrine karshi qytetit. Një natë tjetër, kishin djegur fjalën «Vinçeremo» që e kishin shkrojtur në dhogë.

në një vend tjetër të dukshëm... Por natën duke u gëdhirë 11 nëntori ata kishin ndarë në qytet, bashkë edhe me shumë shokë të tjera, traktin e parë që hidhte Partia Komuniste Shqiptare pas formimit të saj, tri ditë përpara — më 8 Nëntor, në Tiranë.

Ky trakt atë mëngjez ishte gjendur edhe në oborrin e shkollës, edhe nëpër klasa, dhe e kishin lexuar nxënës e arsimtarë. Ja pse ishte aq i gjëzuar atë ditë Qemal Guri. Nxënësit e klasës së pestë nuk kuptionin sa duhej atëhere rëndësinë e formimit të Partisë, por duke parë gjëzimin që vlonët në shpirtin e mësuesit të tyre e muarën me mend se ishte diçka shumë, shumë e madhe për çlirimin e lumenjtërinë e Atdheut e të popullit.

— Jini pregaritur? — i pyeti Qemali nxënësit, duke buzëqeshur, pasi kishte shënuar në regjistër mungesat.

— Po, zoti mësues, jemi pregaritur, — i thanë të gjithë me një zë. Dhe me të vërtetë, si çdo herë tjetër edhe sot, kush shumë mirë e kush mirë, por që të gjithë ishin pregaritur.

Qemal Guri, qysh se kishte ardhur fashizmi, kur i pyeste nxënësit në mësimet e tjera e nuk ja thoshin mirë, i këshillonte e i qërtonte, por po të mos i përgjigjeshin mirë në mësimin e gjuhës, atëherë e kishte vdekje. Sigurisht me fjalë të buta, por i bënte nxënësit sa s'qanin. «Dëgjoni, nxënës», iu thoshte gjithmonë, «sikur të mos kishin luftuar të parët tanë dhe sikur të mos kishin ruajtur gjuhën, si gjënë më të shenjtë, sot as emri nuk do t'ju ndihej Shqipërisë dhe Shqiptarëve. Nuk i mendoni një herë të parët tanë që edhe në furra i digjte Turqia, pse mësonin gjuhën shqipe dhe megjithatë

ata nuk hiqnin dorë?». Pastaj, i drejtohej nxënësit që s'kishte mësuar: «Ti je i madh», i thoshte, «unë nuk mendoj për ty se nuk e do Atdhenë, gjuhën tonë, se nuk je patriot, jo kurrë, por ti përton, nuk mëson. Me dashje pa dashje, ti kështu i bën keq vetes e Atdheut dhe mirë armikut. Më jep fjalën se do të mëssosh më mirë këtej e tutje?» Prandaj rrallë herë qëllonte që t'i vinte ndonjë nxënës i papregatitur në mësimin e gjuhës. Edhe vetë nxënësit ndjenin kënaqësi kur i përgjigjeshin mësuesit «jemi pregetitur», se për ta ishte njësoj sikur i thoshin: «Ne e duam Atdhenë...»

— Ngreu ti Ali në dërrasën e zezë, — i tha mësuesi. — Ju të tjerët shkruani nëpër fletoret. Aliu u ngrit.

Qemali diktoi fjalinë e parë: «Populli shqiptar është i pamposhtur». Aliu e analizoi. Pastaj i diktoi të dytën: «Betimin kundrejt Atdheut duhet ta ruajmë me jetën». Aliu duke analizuar fjalitë e vështronët në sy sikur donte t'i thoshte: «Këto fjalë iu afrohen atyre të traktit. Sa mirë i ndamë. Asnjë rrugë, asnjë shtëpi nuk lamë pa hedhur». Cdo fjalë mundohej ta shkruante me kaligrafi për ta lexuar më mirë shokët. Dora e tij e hollë dhe e thatë i mëshonte shkumësit me tërë forcën që kishte.

Pas Aliut ngriti tre nxënës të tjerë.

Mësuesi iu diktoi: «Shqiptarët kanë luftuar gjithmonë për lirin e tyre». «Pushtonjësit e Shqipërisë i kanë lënë kockat në malet tonë». «Tradhëtarët e Atdheut janë njerëz të poshtër». Ata i analizonin fjalitë që u diktonte mësuesi. Duke dëgjuar, Qemalit i fluturonte mendja gjetkë. Ai sillte ndër

mend mbledhjen që ishte bërë një natë përpara me komunistët e grupeve të ndryshme të atij qyteti, ku kishte folur i deleguari i Komitetit Qendror dhe ku kishte marrë pjesë edhe ai si pjesëtar i grupit Komunist të Korçës e ishte pranuar anëtar partie. Mundohej të merrte me mend luftën kundra fashizmit, që do të zgjerohej,... kryengritjen e armatosur.. të gjitha ato që iu kishte folur i deleguari i Komitetit Qendror.

Donte edhe pesë minuta që të binte zilja e pushtimit. Në këtë kohë hynë në klasën e pestë bashkë me drejtorin një kapter i kuesturës dhe dy rreshtera:

— Sot janë hedhur ca fletushka, zoti mësues, — u mundua t'i thoshte me ton të njerëzishëm kapteri, — dhe vazhdoi: — në klasën tuaj u gjend gjë?

— Jo, — ja preu shkurt mësuesi pa e vështruar fare.

Njëri nga të dy rreshterat, një fytyrkeq, bënte sikur shikonte nga tavani e vërvhellente mengadalë, por me bisht të syrit vështronë nxënësit përtë hetuar se kujt do t'i prishej fytyra.

— Pa, të pyesim këta nxënësit, — tha kapteri, — mos kanë gjetur gjë këtu, në oborr, në rrugë, — dhe iu drejtua fëmijëve: — kini gjetur gjë ju fëmijë të mbarë?

— Jo, jo, — iu përgjegjën dhjetë a pesëmbëdhjetë me një gojë.

— Ata janë të mëdhenj, po t'i kishin gjetur do t'ua jepnin, — ndërhyri mësuesi me një të folur sikur desh t'iu thosh: «Pa shporuni, se na bëtë vapë». — Ata janë në gjendje të kuptojnë të mirën e të ligën, — tha më në fund Qemali.

Dhe me të vërtetë, ata ishin në gjendje ta nda-

nin tē mirën nga e liga se vetë ai i kishte mësuar. Ata që kishin trakte nuk i dorzuan. Trakti thosh: «Lexoje, shpërndaje, armikut mos ja dorëzo». Po ta dorzonin, ata tradhëtonin. Mësuesi iu kishte thënë se tradhëtarët e Atdheut janë njerëz tē poshtër.

— Mirë, mirë, — tha kapteri më në fund duke tundur kokën kur pa se nuk nxori dot gjë dhe doli jashtë.

Ata shkuan në çdo klasë, por asnje trakt nuk u dorzuu në duart e tyre.

— Kjo shkollë është një çerdhe e tmerrshme, — po mendonte me vete kapteri i kuesturës duke dalë nga oborri i shkollës «Naim Frashëri», dhe shfreu: — Ah Qemal Guri, Qemal Guri! Sonte do tē tē kem në duart e mia dhe do ta shohësh edhe ti vetë ç'do tē tē punoj!

Dhe me tē vërtetë, policia fashiste, në bashkë-punim edhe me karabinierinë e milicinë, nga tē katërqind veta që kishte në listë si më tē dyshimtët, kishte caktuar tē arrestonte, kur tē errej, njëzet e pesë prej tyre, ata që i kishte cilësuar si komunistë dhe që ishin nga më tē rrezikshmit.

Kishte njëzet minuta që Qemal Guri kishte hyrë në orën e dytë tē mësimit. Tek ishte duke shpje-guar, e éma trokiti dhe hapi derën me nxitim, por si me tē drojtur që tē mos e pikasnin nga jashtë. Diç i tha tē birit në vesh, pa shikuar nga fëmijët fare dhe i dorzoi një copëz letër.

Shokët lajmëronin mësuesin që tē largohet sa më shpejt, se do ta arrestonin fashistat.

— Bir, ç'do tē bësh? — i pëshpëriti e éma. Buzët,

duart, gjunjët i dridheshin sa nuk qëndronte dot më këmbë e nuk e nxirte dot zërin.

— Ikë ti, ikë. Mos ki merak për mua, — iu përgjegj Qemali.

— Hap sytë bir, mendo për nënën, siguro këkën!... Dal të të puth një çikë së kushedi se kur do të të shoh tanë, **bir!**

I mori kokën ndër duar dhe zuri ta puthte në faqet, në flokët, në ballë.

— Ikë nënë, se po të shohin fëmijët.

Asaj i ishin errur sytë. Atëhere e mbloodi se ishte në klasë dhe ishin gjithë ata fëmijë.

— Bir, si të ikij unë? — vazhdonte t'i thosh eëma dhe hem nisej të ikte, hem nuk i bënин këmbët e s'i ndahej shpirti nga djali.

— Ikë, shko në shtëpi dhe rri e qetë, — i tha Qemali, — se sa më shumë të rrish, aq më shumë është rrezik për mua.

E mori për krahu dhe doli bashkë me të në korridor.

— Po të pyesin për mua, thuaju: «Ka shkuar në Tiranë se ishte i sëmurë», e porositi të ëmën, duke i fërkuar kurrizin e dalë nga vojtjet.

Vetëm kur dëgjoi fjalët e fundit u bind nëna të largohej, duke e mbuluar me të puthura.

Qemali u kthye në klasë me fytyrë të ndryshuar. Mbështeti të dy grushtet në tavolinë si i menduar, për pak sekonda. Në atë çast, iu bë si-kur dëgjonte zërin e të deleguarit të Komitetit Qendror të Partisë, që iu kishte thënë: «Ku ka aksion, ka edhe reaksion. Ne do të luftojmë, por edhe reaksioni nuk do të flejë, do të bëhet më i

egër, do tē tērbohet fare». Nga dritarja e klasës dukej Tomori i mbuluar me dëborë. Sa herë e kishin parë nxënësit e tij tē vështronët andej i menduar e si tē kuvendonte me malin. Ja edhe tani ai i kishte hedhur sytë andej. Por sot, më shumë se kurrë, nxënësit po e kuptionin kuvendimin e heshtur. Me një nënqeshje gëzimi mësuesi i tyre dukej sikur u thoshte maleve: «Dita e dëshiruar erdhi». Pastaj u kthye vetëvetiu drejt fëmijëve, duke i parë një pér një plot dashamirësi. Kishte dy vjet e gjysmë me ta. I kishte edukuar. Kishte shfryjtur dufet e tij me ta kundra armikut fashist. Kishte ndjekur zhvillimin e tyre hap pas hapi. Ishin tē vegjël, në klasën e tretë, kur erdhi në fillim. Tani po i linte më tē rritur. Një pjesë i ishin bërë shokë. Psherëtiu i mallëngjyer. Ç'tiu thoshte? Ai që iu fliste me aq zjarr sa që ua çonte peshë zemrat e tyre kur iu tregonte pér dashurinë ndaj Atdheut, pér trimëritë e shqiptarëve... tani nuk po gjente dot asnjë fjalë lamtumire. Dhembshuria pér ta i vlonë, ruajtja e fshehtësisë pér arratisjen e tij e bënte memec. Nga çasti në çast mund tē vinin fashistat ta arrestonin; ku dihej? Ç'tju thosh? Si tē ikte pa ju thënë gjë? Sytë e fëmijëve e pyesnin: «Zoti mësues, doni ndihmën tonë? Edhe ne duam tē vdesim si ju pér Atdhe, pér popull. Pse nuk na tregoni ç'kini?...» Në klasë ndihej edhe miza, sepse diçka kishte ndodhur, sepse mësuesi diçka kishte! Fytyrat e fëmijëve qenë zbehur nga mallëngjimi, goja u qe terur e mezi kapërdiheshin. Mësuesi pa pér disa çaste rrëth e qark mureve tē klasës fotografitë e Naimit, Samiut, Çerçizit, Ismail Qemalit, Skënderbeut..., tē cilat i kishte prurë e

vendosur me dorën e vet, e dukej sikur i pyeste e sikur kuvendonte me ta pér diçka. Fytyra e tij pér një çast ju duk fëmijëve si ajo e heronje pér të cilët ai ju kishte folur në mësime.

— Fëmijë, — kumboi më në fund zëri i mësuesit, sa i fuqishëm, aq edhe i mallëngjyer, — hapni fletoret e hartimit dhe bëni këtë hartim: «*Atdheu është më i shtrenjtë se jeta*». — Temën e shkrojti me dorën e vet me kaligrafi në dërrasën e zezë. Pastaj, kaloi pér pak prapa dërrasës së zezë, diçka bëri atje, dhe si mori një kasketë nga ato të punëtorëve, që e mbante ngahera në krye, dhe si iu hodhi edhe një vështrim të vetëm pér të pasur kujtimin e fundit të atyre fytyrave aq të dashura u largua qetë - qetë. Në ecje e sipër e thirri Alinë t'i shkonte pas dhe diç i tha atij në korridor. Kur doli në oborr ktheu kryet nga dritaret e klasës së vet. Fëmijët kishin dalë të gjithë në to të heshtur dhe me heshtjen e tyre, pse ashtu duhej, të ruani fshehtësinë sikundër i kishte porositur ai, i bëhej sikur i thërrisin që pas: «Mësues, edhe pse s'na thatë, ne e kuptuam, ju na e thatë me vetë temën e hartimit; ju po shkoni të delni komit maleve si Çergizi. Të kini besim mësues, se edhe ne, hartimin që na dhatë, do ta shkrumë si ju, këtu në qytet e në malet tonë, me gjakun tonë».

Të nesërmen, që në orën e parë, kapteri i kuesturës bashkë me të dy rreshterët erdhën, përsëri në shkollën «Naim Frashëri» pér të kontrolluar. Kur lexi kapteri në dërrasën e zezë fjalët «*Atdheu është më i shtrenjtë se jeta*» i ra asaj me zemërim. Dërrasa e zezë u rrrotullua. Nga ana tjetër, ishte shkrojtur prapë me kaligrafi: «*Rroftë Partia Ko-*

muniste Shqiptare!». Atëhere u tërbua fare.

— Ngrehuni, fshijeni! — iu kërcënuar nxënësve duke kërcitur dhëmbët, por pa iu drejtuar askujt.

Asnjeri nga nxënësit nuk u ngrit. Që të gjithë menduan atë çast që sikur edhe t'i vrisnin ata nuk do ngrihen në fshinin atë që ishte shkrojtur me dorën e mësuesit të tyre.

Kapteri e pa qartë se asnje nga fëmijët nuk do të ngrihej. Prandaj mori fshirësen dhe e fshiu vetë.

Por fjalët: «Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!» «Atdheu është më i shtrenjtë sejeta», që kishte shkrojtur Qemal Guri në dërrasën e zezë, nuk u fshinë kurrë nga zemrat e nxënësve të klassës së pestë. Përkundrazi, sa ditë që kalonin, ato u rrënjosën edhe më thellë, se ato fjalë ai ua pati skalitur më parë në zemrat e tyre të njoma.

BURIMET E ZOTIT KRYETAR

Kryetari i Bashkisë së qytetit X..., Eshref Bej Maliku, kishte një javë që nuk delte në zyrë. Të hënën e kaluar ai dërgoi shërbëtorin në bashki te kryesekretari dhe e lajmëroi se nuk e ndjente veten mirë. Kushdo që do ta kërkonte t'i thosh që nuk e dinte ku ishte. Mirëpo ja, iku java, erdhi e hëna tjetër, dhe gjendja në bashki ishte gjithnjë ajo që kishte lënë. Nëpunësit, që te policët, protokollistët, arshivistët, sekretarët, dhe mandej të-rë punëtorët — fshesarët e të tjera, bënin nga bënин dhe vinin zinin vend te dera e kryetarit, nëpër korridoret e gjithandej dhe kërkonin rrrogat. Ata kishin tre muaj pa marrë rrögë dhe u kishte vajtur shpirti në majë të hundës.

Gjatë asaj jave që u end sa në një kafe në tjetrën, herë duke bërë ndonjë «poker të vogël», herë ndonjë tombull, Eshref beu vrau mendjen e u përpoq si e si t'i gjente një zgjidhje kësaj pune, mirëpo nuk kishte nga ta kapte. Taksat e mbledhura edhe atë muaj, sa mezi mjaftuan për rrrogën e tij, të komiserit të policisë, të kryesekretarit e të ndonjë tjetri. Shtrëngesa që bëri komiseri i pollicisë, për të mbledhur taksat ndër ata qytetarë që nuk i kishin paguar, nuk dhanë asnje përfundim.

Disa nga ata që nuk kishin paguar pranuan të burgoseshin. Ndonjërit që pati ndonjë plaçkë në shtëpi ose në dyqan ja sekuestruan, ja nxuarrën edhe në ankand, mirëpo megjithëse shiteshin me një çmim gati sa të thoshe se ishin të falura, asnje nuk shkonte t'i blinte, ose edhe në shkonin, i paguanin aq sa ishte turp ta zije në gojë çmimin që jepnin.

Eshref bezë Maliku u ngrit në mëngjez vonë, siç ngruhej kurdoherë, pak i mbufatur nga sytë, se e kishte tepruar ca me të pirë darkën e kaluar te kryetari i gjykatës së prefekturës dhe pse kishte lojtur poker gjer ndaj të gdhirë. Si piu kafenë pa lojtur nga shtrati, u çua me përtesë, u rrojt, lau sytë e po mendohej të delte në zyrë apo jo. Po t'i dërgonte kryesekretarit shërbëtorin e t'i thoshte: «beu nuk e ndjen akoma veten mirë», ai do ta kuptonte, mirëpo sa do të vazhdonte kështu «i sëmurë?». Pastaj a nuk kishin sy ta shikonin, ata që e kërkonin, në kafe «London» apo kudo që vinte? Veç kësaj, ai, kur ishin bërë zgjedhjet, kishte thënë «do bëjmë këtë e do bëjmë atë». Ku ishin tani të gjitha ato pér të cilat qe zotuar? Kishte motmot e ca që ishte zgjedhur dhe jo vetëm që ndonjë përmirësim nuk kishte parë qyteti i tij, por ai nuk kishte mundur të zgjidhte dot as punën e rrogave të nëpunësve e të atyre, pak punëtorëve që mbanë bashkia. «Ai që ishte para meje, zoti Gaq Kalami, si bënte vallë?» pyeti me vete duke iu hapur goja, ngaqë akoma nuk i kishte dalë gjumi mirë, dhe u ngrit, hoqi pizhamat e mëndafshta, veshi këmishën me jakë të ngrirë, pantallonat, jeleku, xhaketën, dhe duke kopsitur një nga një me plogështi follat e jelekut, tha me vete: «Do të dal një herë në zy-

rë pa pastaj shohim e bëjmë». Si vuri kapelen republikë të zezë sterrë në kokë, mori bastunin dhe bëri tatëpjetë shkallëve. Në oborr me dhjetëra lloje lulesh e trëndafilash kishin çelur. Aroma e tyre të kundërmonte. Qëndroi një copë kohë, u mori erë nga dy gonxheve pa i këputur, aroma e luleve sikur ja shpiu trupin, një gjendje e kënaqur shpir-tëre e pushtoi menjëherë dhe i thirri baçevanit, që po ujiste andej thellë në një cepth:

— Si je xha Toli?

— Mirë bez, të falemnderit, të puth dorën zotërisë sate.

— Hajde, hajde ndize një herë.

Ruga që nga shtëpia e Eshref beut gjer te bashkia ishte e tatëpjetë dhe e shtruar me kalldrëm. Sa herë që do të bënte «çak çak» bostuni ritmi-kisht nëpër gurët e atij kalldrëmi, të gjithë dyqan-xhintë apo zejtarët e dinin se po kalonte Eshref beu, dhe shumica fshiheshin, o pse nuk donin t'i shikonte, o pse nuk donin ta nderonin; kurse ndonjëri ngrihej shpejt-shpejt, linjtë ç'kishte në dorë, delte në rrugë dhe e priste me temena, duke u përkulur gjer përdhe. Një gjë e tillë u përsërit edhe sot.

Duke ngjitur shkallët e bashkisë, Eshref beu dëgjoi që po bisedonte kamiseri i policisë me një nga nëpunësit.

— Qentë, qentë! duhen helmuar të gjithë! — i cirrej dikujt komiseri. «Pse s'ke marrë helmin në farmaci?

Dhe nëpunësi i thoshte:

— Ne duam helmin për vete, zoti komiser; po na vdesin fëmijët për bukë!

Eshref beut iu bë sikur e dëgjoi edhe «drangen» i mori erë pa qejf trëndafilit që mbante në dorë, dhe prapë bëri përpjetë.

Me të hyrë në zyrë, thirri kryesekretarin.

— E, zoti Llazar, ç'kemi?

— Ja, Eshref bej, sikundër ju thashë edhe pardje në Kafen e Burhanit, ata të pastrimit...

— Leri ato, — e ndërpree ai, — nga Tirana, nga Tirana, ka ndonjë përgjigje?

— Po.

— E ç'thotë shkëlqesia e tij?

— Telegrami është firmuar nga kryeinspektori.

— Mirë. Ç'thotë?

— Si gjithmonë.

Eshref beu, ashtu siç kishte të dy duart mbësh-tetur mbi tryezë i mblodhi grusht, dhe përsëriti me vete disa herë fjalën «si gjithëmonë», pa ditur kundër kujt të shfrente. Me siguri që në zgjedhjet e ardhme ai do ta kishte të humbur davanë. Pak kandidatë kishte përvendin e tij! Më kryesori ai që pati qenë më parë, se kishte edhe miq të fortë. Pas tij vinte i vëllai i Eshref beut, me të cilin shkonte si macja me miun; vinte mandej Jorgaq Gazina, që të peshonte me para. «Mirë xhanëm, — mendoi me vete, — po shkëlqesia e tij ministri i punëve të brendshme, që më përkrahu në zgjedhjet e fundit dhe fitova, përsë s'më ka marrë një herë vetë në telefon që kur i kam ngritur problemin e rrogave?! Mos më është zemëruar? Mos më quan të pazotin? Ai vetë ka porositur të më përgjigjet kryeinspektori vazhdimisht në të njëtën mënyrë, apo i bën përgjigjet kryeinspektori i bashkive me kokën e vet?» Pastaj,

iu drejtua kryesekretarit, duke u shtirur sikur nuk e trubullonte asgjë:

— Pa ma sill atë përgjigjen e fundit.

Kryesekretari u ngrit dhe pas pak i pruri një trumbë telegramesh. Eshref beu i lexoi me radhë sikur të mos ishte aspak në dijeni të tyre. Në ato që ishin dërguar me firmën e tij ishte përsëritur e njëjta gjë: «Arka e financës së kësaj bashkie nuk posedon para për të paguar rrrogat e nëpunësve. Gjendja është e keqe. Na njoftoni si të veprojmë.» Dhe në përgjigjet e ardhura nga ministria e punëve të brendshme, të firmosura gjithmonë nga krye-inspektori, thuhej vazhdimisht: «Për zgjidhjen e problemit tuaj, ju porositim të bëni çezma, rrugë, parqe, kanalizime...» Këto fjalë, pa asnjë presje ndryshim, ishin përsëritur edhe në telegramin e fundit, i cili ishte në krye të asaj trumbe telegrafesh.

Eshref beu ja zgjati dosjen me shkresa kryesekretarit pa i thënë asnjë fjalë. Ai e mori në dorë, priti disa sekonda më këmbë përballë tij mos e porositte për gjë, dhe i heshtur u tërhoq në zyrën e vet.

Kur mbeti vetëm, Eshref beu vuri bërrylat mbi tryezë, mbështeti kryet në të dyja duart, të mbledhura grusht dhe po mendohej: «E po kësaj si i thonë? Unë kërkoj para të paguaj nëpunësit, shkëlqësia e tij me përgjigjet: «bëj rrugë, çezma!... kanalizime!...» Me se t'i bëj unë? me... O jam unë budalla e nuk kuptoj, o është ai i çmëndur dhe nuk di ç'më thotë! Sidoqë të jetë, në zgjedhjet e ardhme fluturova. U pa kjo punë. Shkëlqesia e tij, si duket, me këto përgjigje që më ka dhënë

më térheq vëmendjen e më thotë: «Le që problemin e rrogave nuk ta kam për gjë dhe duhet të dish ta zgjidhësh me sy mbyllur, por ti duhet të bësh këto që të porosit: çezma, ura, parqe... se kështu mbahet vendi i kryetarit të bashkisë, jo me profka. Pérndryshe... mbath këpucët e ikë Eshref bej!» Duke menduar kështu u drodh sikur me të vërtetë t'i kishin thënë në atë çast të merrte bastunin e të delte nga bashkia një herë e përgjithmonë. Këtu nuk ishte çështja se ai nuk kishte të hante. Ai, përveç çifliqeve me dy - treqind shtëpi bujqish, zotëronte edhe gjysmën e godinave të dy-qaneve dhe të shtëpive të qytetit, por mendonte t'i shtonte ato akoma më shumë. Duke qenë në atë vend që kishte, mundte të milte të ardhura ekstra për të përballuar shpenzimet e shumta që do t'i duheshin. Ja, nga arka e bashkisë kishte marrë... (Nejse kjo ishte një gjë që e dinte ai, kryesekretari dhe një nga anëtarët e këshillit bashkiak, me të cilët i pati ndarë). Por të ardhura të tjera të majme ishin ryshfetet e tregëtarëve që i takonin. vetëm atij, dhe me to e të tjera si ato do të mundte të bënte edhe disa sërë dyqanesh të reja, disa shtëpi banimi të reja... Dhe dëshira më e madhe e tij, që i nxirrte gjumin natën, ishte të bënte një hotel të madh mu në zemër të qytetit. Pastaj... pastaj kot nuk e kanë thënë atë fjalën që «paraja vete te paraja», përsë të mos ngrinte më vonë edhe një fabrikë mielli siç bëri Siri beu në Fier, ose edhe fabrika të tjera më të mëdha? «Duhet mbajtur ky vend», tha më në fund tërë nerva, si të kacafytej me një armik të padukshëm, por që e torturonte. Shumë herë qe matur të kërkonte të lidhej vetë

direkt me telefon me shkëlqesinë e tij ministrin e punëve të brendshme, mirëpo pati drojtur mos e shante, jo për gjë, por pse e kishte si njerinë e tij dhe pse ishte njeri me orë. Kushedi, mund të qëllonte në orët e këqija, dhe, në vend që t'i shpjegonte ç'donte t'i thoshte me ato urdhëra «ndërto çezma»... i jepte mandatën: «Ikë ti, se të pata pandehur për njeri të zotin, po nuk më dole asgjë e nuk vleke asnjë para. Kur të bëhen zgjedhjet e tjera, bëhu gati t'i lëshosh vendin...» Po sido që të bëhej, ai sot e vendosi ta merrte shkëlqesinë e tij në telefon vetë direkt, dhe pasi fshiu djersët me një shami duarsh të bardhë si bora, pa e kuptuar as vetë pse i kishin dalë aq shumë, ngriti dorezën e receptorit dhe i ra ziles. Zemra filloi t'i rrihte me forcë.

Centrali i qytetit të tij e lidhi në minutë me Tiranën dhe ai i Tiranës me shkëlqesinë e tij.

— Alo! — Përpara syve i rrinte shkëlqesia e tij ministri i punëve të brendshme, i mërzitur, me vetullat të rrudhura e ballin të ngrysur, e që dukej sikur e qërtonte: «Ikë mor Eshref, se diç të dijta, po s'më dole gjë!» Pështyma iu ter në gojë.

— Kush je?

— Shkëlqesi, shkëlqesi... jam Eshrefi. Eshref Maliku.

— Ç'do? Jam Musa Juka.

— Shkëlqesi... Sot... Sot muarrëm përgjigjen...

— E di, e di. Më lerë të qetë. Kam nisur përaty para dy orësh kryeinspektorin.

— Shkëlqesi... po unë...

— Më lerë të qetë të thashë!

Eshref beu iu bë sikur e dëgjoi edhe «drangen» e receptorit që lëshoi me zemërim shkëlqesia e tij, dhe zëri u pre menjëherë. Zemra i theri si t'i që ngulur një heshtë me helm. Sa e tmershme! I tronditur, u zbe në fytyrë. Balli iu mbulua edhe më shumë me djersë. Pastaj iu muarën mendtë dhe rëndoi mbi kolltuk si ndonjë trup pa jetë.

«Mbarova!» mendoi me vete. «Kryeinspektori vjen me urdhërin e zgjedhjeve të reja në xhep. Akuza: i pazoti për të drejtuar jetën e qytetit. Domosdo, kur do ta shkarkosh tjetrin, mund t'i nxjerrësh në sheş edhe gjëra si ato të përvetësimit që kam bërë unë. Me këtë fiton edhe kredi për vete. Shkëlqesia e tij «do njerëz që t'i bëhen krah i djathtë». Kurse unë... .

Në këtë kohë një borie maqine gjëmoi para godinës së bashkisë si me mburrje dhe frenoi me zhurmë. Eshref beu brofi e doli në ballkon. Një borie tjetër ra më me mburrje akoma. Ja edhe një veturë e tretë. «Erdhi!» tha Eshref beu. «Ai është!» Mbylli sytë e në të njëjtën kohë zuri me tre gishtat lëkurën në shtek të vetullave si të harronte një kob që po e pllakoste. Dhe kur i hapi prapë, vuri re që një kapter doli nga vutura e mezik dhe shkoi hapi derën e pasme të po asaj vture. Në atë kohë Eshref beu pa kokën tullace të Xhafer beut që po delte i kërrusur nga vutura, me një çantë nën sqetull. «Atje brenda është mandata ime!», mendoi duke parë çantën. Xhafer beu sapo doli, drejtoi trupin rrumbullak, sa të gjatë edhe të gjerë, vuri kapelën e zezë republikë në kokë dhe vështroi nga ballkoni. Kur pa kryetarin e bashkisë e përhëndeti gjithë përzemërsi dhe i tha:

— Ah, qerrata! qerrata! ç'na mundon kot e na prish rehatin!

Eshref beut iu duk sikur i tha me ato fjalë: «Tërë qarku i X... éshtë prona jote». Vuri gishtat e dorës së djathëtë në buzë, i dërgoi kryeinspektorit një të puthur nga ballkoni dhe shpejt e shpejt hyri në zyrë. Çudi! Zyra iu duk tani plot dritë dhe dielli pranveror hynte nga të dy dritaret me tërë shkëlqimin e rrezeve të veta. Rendi shpejt e shpejt tatëpjetë shkallëve dhe afër fundit arriti Xhafer benë, kryeinspektorin e bashkive, «gojën dhe veshin e vetë Ministrit», që po vinte te ai për ta këshilluar.

— Po pse mor **qerrata** na mundon kot? — përsëriti me përkëdheli kryeinspektori dhe i dha dorën topolake, tjetrën ja hodhi në sup. Eshref beu, sado që nuk i takonte ajo iniciativë, nuk e përmbajti dot veten, dhe i afroi buzët e u puthën. «Sidoqë të jetë», mendoi ai, «ky ndonjë lajm të keq përmua nuk bie, se përndryshe nuk do të më sillej në këtë mënyrë. Edhe në qoftë se ka ndonjë gjë, éshtë e mira ta puth, se...» Me mendje përkëdheli shkëlqesinë e tij: «Ah, Musa efendi, Musa efendi, të njoh mirë unë ty...»

Duke ngjitur shkallët, Xhafer beu përsëriste me krahët shtritur përpëra e pëllëmbët hapur:

— Pse na mundon xhanëm, pse na mundon?...

— Po unë... Po unë...

— «Ç'po unë!» «ç'po unë!» Po bëj mor jahu çezma, ura, rrugë, kanalizime...

Sa shkallë ngjitetë aq edhe objekte numëronte kryeinspektori. Nëpunësit që kishin dalë ta prisnin, dëgjonin urdhërat e tij me sy të shqyer e të habitur.

— «Po i njëjti avaz!» mendoi Eshref beu. «Me

se t'i bëj unë këto?...» dhe duke e vështruar kryeinspektorin në dritën e syrit, donte të kuptonte në bënte shaka apo i kishte me gjithë mend ai ato që thoshte e numëronte.

— Mirë, Xhafer bej, po qyteti ynë...

Nuk dinte ç't'i përgjigjej, sepse s'ishte aspak në gjendje të kuptonte edhe tani ç'donte ta udhëzonte kryeinspektori; nga ana tjetër, në asnje mënyrë nuk i vinte mirë të tregonte edhe veten se ishte i trashë.

— Hajde, hajde vemi pesë minuta në zyrë, — tha kryeinspektori, — të të jap porosinë që më kanë dhënë, dhe pastaj të dalim.

— «Çështje pesë minutash qenka e tëra», mendoi kryetari i Bashkisë, — dhe tha me keqardhje për vetëveten: «Qenkom me të vërtetë i trashë! Të shohim ç'e ka porositur Musa efendia!»

Tani frikës së heqjes nga kolltuku ja kishte zenë vendin kurioziteti, jo një kuriozitet për gjepura, por për dyqane, shtëpi...

Kur qenë të dy vetëm për vetëm e kokë më kokë, kryeinspektori me një ton sa qortonjës, aq dhe përkëdhelës, po më shumë këshillonjës, i tha:

— Ka nevojë qyteti për çezma të reja?

— Shumë.

— Shumë mirë. E sheh? Ja një burim të ardhurash.

— Po për kanalizime?

— Ca më shumë akoma. Më falni shprehjen, por po qelbet dynjaja.

— Një burim akoma më i madh të ardhurash.

— Rrugë duhen?

— Duhen.

— Po klube, lulishte?

— Domosdo.

— Po ç'do më atëhere? Veç e keqja është se ju nuk kini eksperiençë në këto punë, Eshref bej! Nuk kini eksperiençë! Këtë konkluzion e nxjerr se ju akoma nuk do më kuptioni...

Eshref beu e pa me të vërtetë me një vështrim e me një shprehje prej guaku.

Kryeinspektori vazhdoi:

— Bëj një plan sa çezma duhen, sa atë, sa këtë. Hidh parullën se për t'i bërë këto do verë fondet e saj bashkia, por duhet edhe ndihma e popullit në të hoila; hidhi popullit taksa të reja përkëtë qëllim: një lekë atij e pesë lekë këtij. Të gjithë do të përpilen t'i paguajnë këto taksa, se duan ujë mileti. — kryeinspektori vuri buzën në gaz si t'i thosh Eshref beut: «E sheh, kësaj i thonë zgjuraresi! Duhet të të pjellë mendja!» pastaj e mori fjalën përsëri: — Domosdo, ndonjërit, kë ta shohësh ti vetë të arësyeshme, bjeri kokës mirë me këtë rast, se kështu e ka kjo, botë: «shtrydhe fort limonin sa ta keshë në dorë». Këshilli bashkiak, atyre që duhet, t'u hedhë taksa më të mëdha. Ti ulua pak me nisiativën tënde më vonë, po me kusht që të t'i dorëzojnë ty në dorë të hollat. Po të kundërshtoi ndonjëri, ti miku personal i ngushtë i Musa efendisë, ke edhe gurin edhe arrën në dorë, po nuk besoj ta bëjë njeri këtë. Për këtë qëllim shit edhe ca prona të bashkisë.

Eshref beut akomo nuk i kishte ikur vështrimi i ngrirë prej kaqoli. Kryeinspektori e pa se kishte përpara një naiv në punë bashkie e i duhej thënë

copë: «vidh, mor derr, vidh ku të mundish e si të mundish,» prandaj vazhdoi:

— Pastaj: njëzet çezma janë në plan? Po të tëra ato të shkreta nuk bëhen dot. Njërën çoje gjer në gjysëm, të tretën vetëm sa ta fillosh. Të tria këto të zgjaten tre vjet. Dhe taksat në popull për këtë qëllim të mos ndërpriten. Të vazhdojnë vit për vit dhe të lëvizin në rritje jo në ulje.

Dy fjalët e fundit kryeinspektori i tha me një ton të veçantë. Sytë e Eshref beut po mernin një ndriçim. tjetër. Kryeinspektori e nuhati se ai po e kuptonte. Megjithatë e pa të udhës që «ta instruktante» edhe ca këtë qyqar.

— Kështu si për çezmat, fjala vjen, — tha ai, — do të veproni edhe me kanalizimet, lulishtet, e të tjera e të tjera. Shih, mo, shih si bëjnë gjithë kryetarët e bashkive! Një gjë më çudit me ju, Eshref bej: Si nuk keni mundur xhanëm të përfiton nga eksperiencë e atij që i zutë vendin! Duke vepruar kështu si po ju them, arka nuk do t'ju mbetet bosh kurrë dhe do kini, zoti kryetar, do të kini burime... E shikoni ç'burime apo jo?!

Kryeinspektori heshti një grimë dhe gati sikur t'i thërriste në rrëzë të veshit, përsëriti për të fundit herë, pa e shprehur mendimin gjer në fund, duke qeshur e duke e gudulisur Eshref beun në brinjë:

— Buriiime!...

Eshref beu e kuptoi ç'donte t'i thoshte kryeinspektori me atë thirrje «Buriiime!» dhe me atë gudulisje. Burime për të realizuar endrat e tij... Dhe tërë lajka e përhirime e ndërpreu:

— Ju lutem, Xhafer bej, ju lutem, mos u shqetësoni më, se kini ardhur edhe i lodhur nga Tirana. Kjo paska qenë si veza e kristofor Kolombit. Më ardhka turp që u tregova kaq i trashë dhe ju mundova edhe zotërinë tuaj. Po... mungesë eksperience Xhafer bej, mungesë eksperience!

(17) C. 1983
TIRANA

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Pas mbledhjes	3
Fletë nga ditari i një agronomi	19
Hija e zezë e efendit	28
Djali i madh i Ramo Kullës	38
Me «Pleqtë e Perondisë»	56
Pse u largua xixëllonja nga shtëpia	66
Lumturi	74
Duke udhëtuar me tren	82
Ditën e fundit në mësim	90
Burimet e zotit kryetar	101